



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit me Karakter Profesional në:

“Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”

Kolegji Profesional i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Eli Vyshka

Dr. Gazment Qatipi

Two handwritten signatures in blue ink. The top signature is for Dr. Eli Vyshka, and the bottom signature is for Dr. Gazment Qatipi. The signatures are stylized and overlap slightly.

Prill / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”

| | | |
|----|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Kolegji Profesional i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Program studimi me karakter profesional Diplomë Profesionale në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: Urdhëri/VKM për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licencën: | VKM nr. 699, datë 26.08.2015 UMASH nr. 426, datë 06.11.2015 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | VBA nr.82, datë 21.09.2017 |
| 7 | Regjistrimi i Formës së diplomës: | UQSHA nr. 433, datë 17.12.2020 ¹ |
| 8 | Cikli i studimit: | Program studimi me karakter profesional |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 kredite (ECTS) |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 5 i KSHK |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 8 PAE / 7 PAK |
| 18 | Numri i studentëve për dy vitet e fundit 2020-2023): | 2021 – 2022 11 studentë 2022 - 2023 22 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | |

¹ Ky urdhër ka zëvendësuar UQASHA nr.15, datë 06.02.2018




PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” (më tej TAK), që kërkohet të akreditohet periodikisht është licensuar me: VKM nr. 699, datë 26.08.2015 dhe më pas, sipas kërkesave ligjore të asaj periudhe merrej licenca për ushtrimin e veprimtarisë. Kjo licencë është lëshuar me UMASH nr. 426, datë 06.11.2015 “Për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licencën”. Programi përgatit profesionistë në fushën e asistencës në projektim, zbatim dhe mirëmbajtje të sistemeve të Ngrohjes, Ftohjes, Ventilimit dhe Ajrit të Kondicionuar (HVAC).

Akreditimi i parë i programit të studimit TAK është bërë me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 82, datë 21.09.2017, “Për akreditimin e parë të programit të studimit 2-vjeçar me karakter profesional, pas arsimit të mesëm në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” për një afat 6 vjeçar. Në këtë vendim janë dhënë edhe rekomandime, për plotësimin e të cilave shih më poshtë.

Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara (më tej DEMSA)


Njësia Kryesore në të cilën bën pjesë DEMSA është Kolegji Profesional i Tiranës (më tej KPT).

Regjistrimi i formës së diplomës është bërë me Urdhër të Qendrës së Shërbimeve Arsimore nr. 433, datë 17.12.2020.

Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Diplomë Profesionale” në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi në dy fundit (2021-2023) është 34 studentë

KPT ka aplikuar në ASCAL më datë 06.03.2023 për akreditimin periodik të këtij programi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga ekspertët e jashtëm Dr. Gazment Qatipi dhe Dr. Eli Vyshka, të kontratuar nga ASCAL, që mbulojnë fushat e Inxhinierisë mekanike, të projektimit industrial, etj. Për hartimin e raportit, veç Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (më tej RVB), dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV), grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën e programuar që kreu në KPT, bazuar në agjendën e aprovuar. Gjithashtu ai mori në shqyrtim edhe dokumente dhe informacion shtesë, nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë kësaj vizite, si me drejtues të departamentit, personelin akademik, studentët, përfaqësues të Zyrës së Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, së Kurrikulës, Sekretarisë mësimore, etj.

Në bazë të vlerësimit të jashtëm janë: Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, disa elementë të Ligjit për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve nr. 10247/2010, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i Raportit të vlerësimit të Brendshëm, i dokumentave të sjella nga KPT në DVV, si dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në vend. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që mbulojnë, sigurimit të cilësisë, etj. Analiza në RVJ e mbështetur në evidenca dhe referencat përkatëse, ka vlerësuar programin e studimit, duke përfshirë harkun kohor nga akreditimi i fundit i programit të studimit TAK deri në ditën e hartimit të RVB. Grupi është përpjekur të hartojë një raport konçiz dhe lehtësisht të lexueshëm

Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është Msc. Majlinda Demirneli.

Kolegji Profesional i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 13.03.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 164 Prot, datë 13.03.2024. Kolegji Profesional i Tiranës njofton në ASCAL më datë 25.03.2024, me anë të shkresës me Nr.243/2 Prot, datë 25.03.2024 “Kthim përgjigje mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm periodic për programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

- 1) **Për Komentin që i përket Standardit I.1, kriteri 4:** ku KPT sqaron se në RVJ ka pasaktësi ku Diploma profesionale në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” është përfshirë dhe njohur si kriter kualifikues në kurset e kualifikimit për përgatitjen e aplikantëve që kërkojnë të pajisen me Dëshminë e Aftësisë Profesionale”. KPT saktëson që vetëm Diploma e programit “Teknologji Automjetesh” dhe “Elektro Mekanikë”, janë njohur si kriter kualifikues në kurset e kualifikimit për përgatitjen e aplikantëve që kërkojnë të pajisen me Dëshminë e Aftësisë Profesionale. GVJ falenderon dhe **Raporti ndryshon, duke vendosur fjalën “nuk” përpara “është”.**
- 2) **Për Komentin që i përket Standardit I.2 kriteri 4:** GVJ ka dashur të theksojë në RVJ, që analiza për Marrëveshjet e bashkëpunimit të jetë e veçantë për këtë program studimi, si

mënyrë më e plotë, edhe për faktin se KPT ka mbi 100 bashkëpunime si institucion për 12 programe studimi, të cilat nuk janë në të njëjtën fushë teknologjike dhe kuptohet që edhe mënyrat e bashkëpunimeve janë të ndryshme. Vetëm për programin TAK janë 22 marrëveshje, prandaj GVJ mendon se ky sugjerim (pra jo rekomandim dhe i detyrueshëm), do të ndihmonte institucionin në optimizimin e bashkëpunimeve dhe partnerëve. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

- 3) **Për Komentin që i përket Standardit II.1, kriteri 6:** GVJ nuk gjeti dokumentacion referues që i referohen këtij kriteri. Edhe në RVB është shkruar përgjigja NA. Prandaj GVJ rekomandon (referuar kriterit) që Institucioni duhet të bëjë një analizë të IAL-ve në Shqipëri që ofrojnë një program studimi të ngjashëm dhe të shprehet për përmbajtjen e tij referuar kriterit. Në komentin e tij për RVJ, KPT ka paraqitur një argumentim të plotë dhe mendon se këtë kriter e ka plotësuar. KPT duhej që i gjithë argumentimi i paraqitur për këtë kriter, të jepej që në fillim në RVV, së bashku me dokument/a referues. Megjithatë arsyetimi i KPT qëndron (edhe GVJ në fakt prandaj është shprehur: Kjo kërkesë mund të jetë e plotësuar paraprakisht, por nuk është bërë ndonjë studim). **Raporti në këtë pikë ndryshon dhe në kriter do të vendoset ky tekst:**

GVJ nuk gjeti dokumentacion referues që të shprehet për këtë kriter. Edhe në RVB është përcaktuar përgjigja NA.

Nga komentet e KPT GVJ u informua për të gjithë rrugën e hartimit dhe ecurisë së këtij programi, si më poshtë


KPT është themeluar në vitin 2015, duke qenë një pioner i arsimit profesional të lartë në vend. Në kohën e hapjes së KPT, nuk kishte asnjë IAL e tipit kolegji profesional i lartë. Hapja e KPT ishte një risi në vend në tregun e arsimit të lartë, e bazuar në përvojën më të mirë europiane. Hapja e KPT nuk ishte rastësore por erdhi si rezultat i një punë të gjatë kërkimore në rajon dhe në gjerë në lidhje me arsimin dhe programet e ngjashme që ofroheshin.[...] Grupi nismëtar kreu vizita në Greqi. (në kolegjet e ngjashme IEK si Delta etj), u konsultua me modelin gjerman, të arsimit profesional, me ekspertë vendas dhe të huaj, për të arritur në ofertën e parë akademike me 9 programe studimi, [...].

Gjithashtu një tregues për vlerën dhe cilësinë e këtij programi studimi është përqindja e lartë e punësimit të studentëve të tij, dhe si vlerë e shtuar dhe praktikata e studentëve në vende të ndryshme të Bashkimit Europian. Si i tillë, mendojmë se ky program vjen si një program pioner, që në këto vite është përmirësuar në vijimësi duke reflektuar trendet e teknologjisë dhe inovacionit, dhe për sa më sipër, mendojmë se i takon të shërbejë si referencë praktike e mirë në vazhdim për t'u ndjekur nga të tjerët. Në dijeninë tonë, nuk ka programe me të njëjtin emër, por janë vetëm dy programe që i përkasin fushës: "Specialist i sistemeve të kondicionimit" (UAMD) dhe "Sistemet e Ajrimit të Kondicionuar" (KPGJT).

Gjithashtu bazuar në pikën 6. Neni 86 "Kodifikimi i programeve të studimit", të Ligjit 80/2015. Këshilli i Ministrave dhe Ministria përgjegjëse për arsimin kanë hartuar aktet nënligjore përkatës edhe në bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH, është vënë në zbatim procesi i kodifikimit të programeve, për të cilat KPT i ka aplikuar përkatësisht. Si rezultat i këtij procesi, vihet në zbatim kriteri ligjor që lidhet me përafrimin e programeve të fushave të ngjashme me të njëjtën emërtesë, duke patur si element dallues kodin përkatës. Ashtu si është evidentuar në Raport: Rezulton se është bërë edhe kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional TAK, mbështetur në Udhëzimin e MAS, nr. 31 datë 15.11.2022. Kodi i këtij programi studimi është 52-PP/S-713

Përsa më sipër GVJ gjykon se KPT e ka përmbushur kriterin.

Gjithashtu në rubrikën Konkluzione hiqet rekomandimi 3



- 4) **Për Komentin që i përket Standardit II.1, kriteri 1**, ku GVJ sugjeron rregullimin e pasaktësive në përcaktimin e tipit të lëndës duke përputhur syllabuset dhe veprimtarive (A-E), sipas VKM 879/2019 / dhe korrigjimin e disa pasaktësive në përcaktimin e kategorisë së lëndës në syllabus (A, B, C, D, E) që të përputhen me kategorinë në Tabelën e formave të mësimdhënies. KPT falënderon GVJ dhe deklaroi se ato janë rishikuar dhe ndryshuar. GVJ përshëndet reflektimin e KPT për rregullimin e pasaktësive që sillnin mosplotësimin e kriterëve të VKM. **Raporti në këtë pikë ndryshon dhe shtohet fjalia: KPT pasi lexoi Draft Raportin, deklaroi se janë korigjuar/ plotësuar të gjitha vërejtjet e mësipërme të kriterit 1. Komenti i institucionit pranohet dhe vlerësimi i Standardit ndryshon nga Plotësimi “Kryesisht” në “Plotësisht”.**

Gjithashtu në rubrikën Konkluzione hiqet rekomandimi 4.

Gjithashtu ndryshon vlerësimi i Standardit II.1 nga “Kryesisht” në “Plotësisht”

- 5) **Për Komentin që i përket Standardit II.2 kriteri 2**, GVJ ka menduar dhe mendon se stafi ndihmës akademik është i nevojshëm për të lehtësuar punën e pedagogëve. Por në rastin e KPT stafi akademik është në gjendje të realizojë edhe “teorinë” por ka edhe aftësitë e duhura teknike, që të realizojë proceset laboratorike dhe bën demonstrime të teknologjisë. Për sa kohë pedagogët kanë dakortësuar që t’i realizojnë të dy format e mësimdhënies pra leksione dhe orë laboratorike/apo praktika lëndore GVJ e sheh si një përvojë të re. **Raporti në këtë pikë ndryshon, duke hequr paragrafin e fundit si në kriter ashtu edhe në konkluzione.**

Gjithashtu ndryshon edhe vlerësimi i Standardit II.2 nga “Kryesisht” në “Plotësisht”


- 6) **Për Komentin që i përket Standardit II.3 kriteri 3**, GVJ ka rekomanduar që kriteri gjuhës shqipe të plotësohet ose nëpërmjet mbrojtjes së saj (me diplomë/certifikatë) ose me njohjen e saj (si gjuhë e prindërve). Arsytimi i KPT ka përforcuar edhe më tepër kërkesën e GVJ për t’u shtuar si kriter hyrës, sepse kriteri është: 5) Në programet e studimit pranohen për t’u regjistruar shtetas shqiptarë ose të huaj, (pa u specifikuar fëmijë emigrantësh, apo ...). GVJ mendon se statusi i kandidatit për student duhet të jetë shumë i qartë në kriteret hyrëse. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Plotësimi i Standardit II.3 mbetet “Kryesisht”

Plotësimi i Fushës 2 ndryshon nga “Kryesisht” në “Plotësisht”, sepse nga 5 standardet 4 prej tyre tashmë janë plotësuar “Plotësisht”

- 7) **Për Komentin që i përket Standardit III.5, kriteri 7**, GVJ me sugjerimin e dhënë mendon se ndihmon studentët në njohjen e diplomave të tyre (kur ato lëvizin jashtë vëndit) dhe për këtë është përmendur edhe një praktikë e mirë nga një institucion i ngjashëm. Por në asnjë rast kjo gjë nuk ka ndikuar në vlerësimin e standardit (që është me vlerësim maksimal) dhe nuk është shkruar për të nxjerrë një mangësi serioze Komenti i institucionit pranohet pjesërisht dhe **Raporti në këtë pikë ndryshon**, dhe hiqet emri i IAL që është marrë si shëmbull.

- 8) **Për Komentin që i përket Standardit IV.1, kriteri 2**, Arsytimi i KPT mendojmë se ka kontraditë me arsyetimin që është dhënë për nevojën e stafit ndihmës akademik në zhvillimin e orëve laboratorike, ku jepet si argument që pedagogët i bëjnë edhe orët laboratorike, se kjo rrit cilësinë. Ndërsa këtu arsyetohet që pedagogët bëjnë vetëm “një formë mësimdhënie”.



GVJ ka analizuar të gjitha të dhënat dhe rezulton e saktë ajo që është shkruar në raport.
Raporti nuk ndryshon.

- 9) **Për Komentin që i përket Standardit V.2 kriteri 1**, GVJ përshëndet reflektimin e KPT për rregullimin e pasaktësive në disa dokumenta, që sillnin konfuzion. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

CEV yshley



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin nr 82, datë 21.09.2017, janë:

Institucioni të organizojë rishikimin e syllabuseve në drejtim të përmirësimit të gjuhës teknike në to.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Në RVB si dhe në takimet e kryera nga GVJ deklarohet se:

Institucioni duke vlerësuar rekomandimet e bëra, dhe në frymën e përgjegjësisë dhe angazhimit, ka marrë hapa konkretë në lidhje me to. Rekomandimi u shtruar për diskutim në nivelet e larta drejtuese të KPT, duke u vlerësuar rëndësia dhe njëkohësisht dhe angazhimi serioz i KPT në lidhje me to.



Në lidhje me rekomandimin, Njësia bazë në bashkëpunim me anëtarët e departamentit, mori hapa konkretë dhe bëri rishikimin e përmbajtjes së syllabuseve të programit me synim përmirësimin e gjuhës teknike dhe përditësimin me zhvillimet e reja në tregun e punës.

Ky rishikim është kthyer në një traditë pasi përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në institucion, në përgjithësi si dhe në lidhje me rekomandimin e bërë në Vendimin e BA, është konsideruar një "punë dhe përditësim në vijimësi". Rishikimi merr shkas nga nevojat e tregut të punës, sugjerimet e biznesit, zhvillimet e teknologjisë, përmasa e ndërkombëtarizimit përfshirë vlerësimin e punësimit të studentëve si një nga indikatorët matës të performancës së programit.

GVJ, pasi analizoi punën e bërë për përmirësimin e syllabuseve, konstaton se:

Rekomandimi është përmbushur sepse syllabuset janë përshtatur me nivelin e programit të studimit, si një program profesional jouniversitar. Gjuha e përdorur është e kuptueshme dhe tregon një punë serioze të hartuesve të tyre, Gjithashtu ato janë përshtatur me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga IAL-të" e ndryshuar.

Në përfundim GVJ mendon se rekomandimi është përmbushur plotësisht.



**VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË
“TEKNOLOGJI AJRIMI DHE KONDICIONIMI”**


I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi I.1 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. | |
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | <p>Kolegji Profesional i Tiranës ka synuar që të jetë Institucion lider në ofrimin e arsimit profesional, duke dhënë kontributin e tij për zhvillimin ekonomik të vendit, me mision që të jetë një urë lidhëse midis edukimit akademik teorik dhe trajnimit profesional, duke i ndihmuar studentët në integrimin në tregun e punës. GVJ gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm, nga informacioni i marrë në DVV, nga takimet e zhvilluara me të gjithë faktorët dhe aktorët, mendon se misioni i KPT dhe i programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, (më tej TAK), është në përputhje me interesat kombëtare.</p> <p>Në Strategjinë 2021-2025, hartuar nga KPT gjejmë: “... KPT synon të punojë për thellimin e traditave më të mira akademike shqiptare, me synimin për ta parë KPT si qendër të inovacionit dhe zhvillimit, si dhe për thellimin e sensit të komunitetit dhe bashkëpunimit e të frymës së përgjegjësive sociale”.</p> <p>Ref: Evidenca 3 Statuti KPT, neni 6 Ref: Evidenca 7 Strategjia 2021-2025</p> |
| Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | <p>GVJ gjykon se (sipas Statutit të KPT dhe DVV) programi i studimit profesional 2-vjeçar në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e KPT, si dhe me fushën e veprimtarisë akademike dhe profesionale. KPT duke pasur parasysh stadin në të cilin ndodhet vendi ynë dhe qëllimin kombëtar të integrimin në BE, e konsideron sfidën më të rëndësishme të kohës krijimin e një sistemi efikas edukimi, i aftë të përballojë ndryshimet e shpejta teknologjike, të cilave ju përgjigjet edhe programi i studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”.</p> <p>Ref: Evidenca 7.1 Strategjia 2015-2020 Ref: Evidenca 3 Statuti KPT, neni 31 (3) Ref: Evidenca 4 Rregullorja KPT</p> |
| Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së | <p>Nga leximi i dokumentave si: “Strategjia 2021-2025”, “Rregullore e Programit të studimit”, Organigramën e KPT, etj, GVJ mendon se programi i Studimit TAK është në përputhje me kërkesat e këtyre dokumentave, si dhe ka përputhje me fushat që</p> |




| | |
|--|---|
| <p>Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p> | <p>mbulohen nga Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara (DEMSA). Mendojmë se strategjia për të ofruar programe të tilla 2-vjeçare inxhinierike, i shërben ekonomisë shqiptare, por edhe një numri të madh të rinjsh që duan të futen në tregun e punës me një formim profesional të një niveli të lartë.</p> <p>Ref: Evidenca 7 Strategjia 2021-2025 Ref: Evidenca 3 Statuti KPT, neni 5, 8, 32 Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p> | <p>Sipas RVB, në analizën e tregut, pjesë e Strategjisë së Zhvillimit 2015–2020, janë përshkruar argumentet që mbështetën hapjen e programit TAK, të bazuar mbi nevojat e tregut të punës, të mbështetur në të dhëna konkrete, që në themelimin e KPT në vitin 2015. Tetë vitet e zhvillimit të këtij programi kanë treguar se kërkohet nga tregu lokal dhe kombëtar i punës dhe dëshmojnë kërkesën në rritje për aftësi dhe dije për këtë profesion. Sipas DVV, GVJ konstaton se për organizimin e programeve të studimit dhe planeve mësimore, KPT-ja konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse, për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Diploma profesionale në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” nuk është përfshirë dhe njohur si kriter kualifikues në kurset e kualifikimit për përgatitjen e aplikantëve që kërkojnë të pajisen me Dëshminë e Aftësisë Profesionale.</p> <p>Ref: Evidenca 7 Strategjia 2021-2025 Ref: Evidenca 4 Rregullorja e KPT, neni 14 Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit Ref: Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Ref: Evidenca 31 Takimi me bizneset HVAC</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p> | <p>Nga tabela e të dhënave për stafin akademik që realizon kurrikulën e programit të studimit, rezulton se në vitet akademike 2020-2023 janë përfshirë personel akademik i kualifikuar, i përshtatshëm për lëndët që kanë mbuluar. Në të gjitha vitet personeli akademik ka qenë me tituj/grada apo kualifikime sipas kërkesave ligjore. Nga tabela rezulton se nga 15 pedagogë (8 PAE + 7 PAK), 2 pedagogë kanë titullin Prof. Dr, 1 MND dhe të tjerët janë me kualifikimin Msc.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se KPT ka burimet e duhura (auditorë, laboratorë e oficinë, bibliotekë, mjete didaktike, etj), të cilat janë në shërbim të programit TAK që ofron ky institucion. Sipas RVB e DVV, vizitës në institucion e intervistave me studentët, GVJ konstaton se marrëveshjet e</p> |


| | <p>shumta dhe të përshtatshme me bizneset në fushën përkatëse, mundësimi i praktikave profesionale në vendin e punës, mobilitetet 1-3 mujore në disa vende të BE dhe biblioteka e pasur, tregojnë për burime të duhura për ofrimin me cilësi të programit.</p> <p>Ref: Evidenca 6.1 Tabela e stafit në vite Ref: Evidenca 34 Infrastruktura Ref: Evidenca 22 Laboratorët Ref: Evidenca 21/1 Mobilitetet</p> | | | | | | | | |
|---|---|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|----------|
| <p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>GVJ vlerëson që programi i studimit profesional “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” ofrohet nga Departamenti i Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, në përputhje të plotë midis fushës së studimeve me strukturën akademike e kërkimore të tij.</p> <p>Sipas evidencës 8, KPT ka përcjellë rregullisht pranë MAS propozimin për kodifikimin e programeve, të cilat janë bërë në përputhje me Udhëzimin e MAS, nr. 31 datë 15.11.2022 “Për procedurat e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Rezulton se është bërë edhe kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional TAK. Kodi i këtij programi studimi është 52-PP/S-713.</p> <p>Ref: Evidenca 6.1 Tabela e stafit në vite Ref: Evidenca 48 Artikuj, botime, promo libri Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit Ref: Evidenca 8 Shkresa MAS për kodifikimin e programeve</p> | | | | | | | | |
| <p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kolegji Profesional i Tiranës ofron programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar, “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë bazë Departamenti i Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. - Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. - Rezulton se është bërë edhe kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional TAK, mbështetur në Udhëzimin e MAS, nr. 31 datë 15.11.2022. Kodi i këtij programi studimi është 52-PP/S-713 | | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="627 1827 842 1921">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="842 1827 1050 1921">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1050 1827 1249 1921">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1249 1827 1437 1921">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="627 1921 842 1975"></td> <td data-bbox="842 1921 1050 1975"></td> <td data-bbox="1050 1921 1249 1975"></td> <td data-bbox="1249 1921 1437 1975" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table> | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |



Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, dhe mobilitetit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>Në dokumentat e paraqitura nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” jepen mjaft të dhëna për marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda departamenteve, strukturave organizative të institucionit. Nga takimet në Institucion GVJ gjeti një frymë pozitive nëpërmjet njësive dhe personelit, dhe marrjes së përgjegjësive për kryerjen e detyrave përkatëse. Edhe analiza e punës së tyre reflekton përgjegjshmëri por edhe ndihmë për përmirësim.</p> <p>Ref: Evidenca 3 Statuti KPT, Kreu II, III, IV Ref: Evidenca 29.3 Vendim Rektor për përcaktimin e ngarkesës mësimore staf efektiv Ref: Evidenca 36 Raporti vjetor Ref: Evidenca 9 Mbledhje Rektorati/ Departamenti/ Asamble</p> |
| <p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p> | <p>Nga të dhënat që referohen në RVB dhe nga dokumentat në DVV, GVJ konstaton se KPT/DEMISA kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi, me institucione homologe brenda vendit, si: Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT), Universitetin “A. Moisiu” të Durrësit (UAMD), Universitetin European të Tiranës (UET), Kolegjin Universitar “Insituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT), si edhe jashtë vendit me Universitetin e Thesalisë, Greqi. Këto bashkëpunime përfshijnë dakortësinë për shkëmbime stafi, eksperiencash mësimdhënëse dhe studentësh.</p> <p>Gjithashtu KPT është pjesë e Konferencës së Rektorëve dhe Ligës së Sipërmarrësve në Arsim, si dhe merr pjesë në forumet e ndryshme të IAL-ve. GVJ nga DVV si dhe takimet në vizitë evidenton se KPT është shpalluar fitues në disa projekte të rëndësishme, në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave, mobilitetit, rritjes së kapaciteteve në nivel institucional duke përfshirë edhe këtë program studimi. KPT ka lidhur marrëveshje të ngushta bashkëpunimi edhe me biznese që lidhen me fushat e programeve të studimit që ofron. Nga tabela përkatëse rezultojnë 124 biznese në total që kanë marrëveshje bashkëpunimi me KPT dhe 22 marrëveshje për programin TAK.</p> <p>Ref: Evidenca 10 IAL-Marrëveshjet Ref: Evidence 10.1 – Aktiviteti Konferenca e Rektorëve</p> |



| | |
|--|--|
| | <p>Ref: Evidence 10.2 – MoU_Uth</p> <p>Ref: Evidenca 11 Lista e Projekteve'</p> <p>Ref: Evidenca Tabela TA TAK.pdf</p> |
| <p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p> | <p>Siç u theksua më lart KPT ka nënshkruar marrëveshje me biznese vendase dhe të huaja, në përputhje me objektivat për zhvillimin me sukses të programeve të studimit, për të mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale dhe punësimin eventual të studentëve pas përfundimit të studimeve. KPT e DEMSA kanë arritur 124 marrëveshje bashkëpunimi me aktorët e biznesit vendas dhe të huaj dhe 22 marrëveshje të lidhura vetëm për programin e studimit TAK. Lista e partnerëve gjendet edhe në faqen e internetit të KPT.</p> <p>https://kolegjiprofesional.edu.al/partneret-tane/</p> <p>GVJ mendon se këto marrëveshje janë të përshtatshme për realizimin e objektivave të procesit mësimor, si realizimin e praktikave profesionale, ashtu edhe kërkesat për mobilitet studentësh.</p> <p>Ref: Evidenca 3 Statuti, Neni 6</p> <p>Ref: Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale</p> <p>Ref: Evidenca 33 Lista e partnerëve marrëveshjeve të bashkëpunimit</p> <p>Ref: Evidenca 38 Praktika Connected through Mobility</p> <p>Ref: Evidenca Tabela TA-TAK.pdf</p> |
| <p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se në DVV është vendosur raporti vjetor i analizës së punës së KPT/departamentit dhe në këtë raport është analizuar edhe praktika mësimore dhe bashkëpunimi me kompani të ndryshme. Po kështu është edhe raporti i praktikave, ku jepen njoftimet dhe mënyra e plotësimit të dokumentacioneve e vlerësimi i studentit për praktikën e kryer. Referuar kriterit majtas dhe dokumentacionit në DVV, mendojmë se nuk ka raport analitik të veçantë, të përfitimeve nga marrëveshjet e nënshkuara.</p> <p><i>GVJ sugjeron hartimin e një raporti periodik të përfitimeve për të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkuara, në funksion të përfitimit të studentëve.</i></p> <p>Ref: Evidenca 36 Raporti vjetor</p> <p>Ref: Evidenca 33 Lista e partnerëve marrëveshjeve të bashkëpunimit</p> <p>Ref: Evidenca 5.2 Raporti i praktikave</p> <p>Ref: Evidenca 38 Praktika Connected through Mobility</p> <p>Ref: Evidenca 39 Connect IT Bootcamp</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të</p> | <p>Në RVB është deklaruar se KPT/DEMSA <i>ndërmerr iniciativa</i></p> |

CEVY shka

| | |
|--|---|
| <p>sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p> | <p><i>specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve. Në programin e studimit TAK, përqindja e studentëve të diplomuar që janë punësuar është në nivelin 90%, (të dhënat janë vetëm për vitin 2021-2022), ndërsa përqindja e studentëve të punësuar në profesion është 72%, ku një pjesë e studentëve janë punësuar që gjatë praktikave profesionale 6-javore që zhvillojnë pranë institucioneve në terren. GVJ takoi përfaqësues të Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, të cilët treguan se kishin marrë disa iniciativa në mbështetje të punësimit të studentëve, si aktivitete promovimi, takime me alumni të suksesshëm, etj, që nxisin punësimin e studentëve të diplomuar. Gjithashtu GVJ konstatoi se studentët e intervistuar ishin të punësuar, sapo kishin përfunduar studimet.</i></p> <p>Ref: Evidenca 12 Sondazhi Alumni Ref: Evidenca 44 Thirrje / Njoftime Punësimi</p> |
|--|---|

Konkluzione

- *GVJ konstaton se KPT/DEMSEA kanë siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, etj.*
- *Marrëveshjet e bashkëpunimit përfshijnë kryesisht termo-servise dhe termo-implante, që ndihmojnë në kryerjen e praktikave profesionale e ku studentët janë punësuar pas diplomimit.*
- *GVJ sugjeron hartimin e një raporti periodik të përfitimeve për të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara, në funksion të përfitimit të studentëve.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |


Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.


| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> | <p>Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e DVV, GVJ konstaton se KPT ka struktura të ngritura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me kërkesat ligjore/nënligjore dhe me aktet e vetë institucionit. Strukturat përgjegjëse institucionale deklarohen në organigramë. SBC realizohet nga vetë KPT nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturave hierarkike organizative të KPT (Rektori, senati, dhe përgjegjësat e departamenteve), të cilat planifikojnë, |



| | |
|--|---|
| | <p>dhe garantojnë zbatimin e procedurave akademike dhe mësimdhënies me cilësi.</p> <ul style="list-style-type: none"> Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, që ka si objektiva të saj monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së programeve të lëndëve, përmirësimit të vazhdueshëm, përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së mekanizmave zyrtarë, për vlerësimin periodik të programeve, të monitorimit të procesit të mësimdhënies, ecurisë së kërkimit shkencor, etj. <p>Ref: Evidenca 3 Statuti, Neni 11 Ref: Evidenca 3.1 Organiograma Ref: Evidenca 13 Vendim i ngritjes së NjSBC E 13.1 Rregullore NjSBC.pdf</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> | <p>Nga DVV, RVB dhe nga takimi me përfaqësues të NJBSC u konstatua që në KPT janë ngritur dhe funksionojnë strukturat e brendshme të sigurimit të cilësisë. NJBSC përbëhet nga 6 anëtarë, përfaqësues të departamenteve, të stafit administrativ, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga këshilli studentor.</p> <p>NJBSC është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të institucionit. Në Rregulloren e NJBSC gjejmë detyrat e kësaj njësie [cit]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Vlerësimi, rishikimi dhe përmirësimi i programeve dhe syllabuseve mësimore;</i> <i>Mbarëvajtja e zhvillimit të procesit akademik;</i> <i>Realizimi i orarit të zhvillimit të orëve të mësimit, leksione, ushtrime, laboratore dhe praktika mësimore;</i> <i>Zhvillimi i procesit të vlerësimit të pedagogëve për çdo lëndë nga ana e studentëve;</i> <i>Mbarëvajtja e zhvillimit të provimeve përfundimtare dhe cilësia e korigjimit të tyre;</i> <i>Vlerësimi i procesit të organizimit të praktikave profesionale dhe cilësisë së realizimit të tyre;</i> <i>Monitorimi i sekretarisë mësimore për procesin e hedhjes së notave;</i> <i>Monitorimi i vlerësimit të pedagogëve më të rinj nga ana e pedagogëve më me përvojë, etj.</i> <p>Edhe strategjia e re 2021 ka sigurimin e cilësisë si fokus kryesor.</p> <p>Ref: Evidenca 3 Statuti, Neni 16; Ref: Evidenca 13 Vendim i ngritjes së NjSBC Ref: Evidenca 13.1 Rregullore e NjSBC Ref: Evidence 15 Formularet e vlerësimit Studente</p> |

CEVY shlep 

| | |
|--|--|
| | <p>Ref: Evidencë 16 Fokus Grupe Ref: Evidencë 17 Tutoriatet/ këshillim akademik</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> | <p>Treguesit për sigurimin e cilësisë në KPT janë të përfshira në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kodin e Cilësisë, standardet dhe kriteret përkatëse të të cilit përbëjnë treguesit e matshëm për sigurimin e cilësisë; • Aktet rregullatore (të procesit mësimor, në rregullat e sigurimit të laboratorëve, shëndetin dhe sigurinë e studentëve, etj). <p>Instrumentet për sigurimin e cilësisë në KPT janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportet vjetore të institucionit, • Planet e punës mbi mbikëqyrjen dhe vlerësimin periodik të veprimtarisë akademike dhe administrative të KPT, • Pyetësorët, focus grupet, • Bashkëpunimet për ekspertiza (përfaqësuesit e bizneseve, ekspertët e jashtëm) • Strukturat e sigurisë (Këshilli i Sigurisë, Mjeku, trajnimet për ndihmën e shpejtë, etj). <p>KPT i është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin e parë dhe periodik institucional sikurse dhe të programeve të studimit. Gjithashtu pjesë e monitorimit janë vizitat monitoruese të MAS mbi kapacitetet akademike dhe infrastrukturore, në funksion të miratimit të kuotave, raportimi për verifikimin e kontrollit të ligjshmërisë ndër vite, etj. Akreditimi i parë institucional u bë në vitin 2017, akreditimi periodik institucional është bërë me VBA nr. 08, datë 27.01.2023. Ndërsa programi i studimit profesional TAK u akreditua për herë të parë me VBA nr. 82, datë 21.09.2017. Ky është raport që i shërben akreditimit periodik të TAK.</p> <p>Ref: Evidenca 3 Statuti, Neni 11 Ref:Urdhër nr.16, datë 8.5.2023 për ngritjen e GVB për akreditimin periodik të programit TAK Ref: VKM Nr. 699, datë 26.08.2015 Ref: VBA Nr. 66, datë 21.09.2017; Ref: VBA nr.8, datë 27.01.2023 Ref: VBA nr. 82, datë 21.09.2017 Ref: Evidenca 13.1 Rregullore e NjSBC Ref: Evidence 15 Formularet e vlerësimit Studente Ref: Evidencë 16 Fokus Grupe Ref: Evidencë 17 Tutoriatet/ këshillim akademik</p> |



Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.

Për vlerësimin e mësimdhënies NJBSC:

- Miraton planin vjetor;
- Kontrollon, përmirëson kurrikulën, syllabuset dhe cilësinë e mësimdhënies;
- Realizon dhe analizon pyetësorët, intervistat e studentëve, pedagogëve dhe alumni;

Në rregulloren për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë (të matshëm, që pasqyrojnë arritjet dhe dobësitë). NJSBC vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, të institucionit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Raportet diskutohet në të gjitha njësitë e institucionit, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. Nga RVB dhe DVV dhe nga takimi me përfaqësues të NJBSC, GVJ konstatoi se ajo përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, pedagogëve dhe alumni. Vlerësimi për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor për stafin akademik realizohet: nga vëzhgimi i leksioneve të hapura, vlerësimi i studentëve, nga vlerësimi i drejtuesit të departamentit, rezultatet nga aktiviteti shkencor i tyre, etj.

Promovimi i stafit shkon në vijim me përfshirjen në projektet ndërkombëtare siç janë Erasmus + CBHE dhe në hartimin e legjislacionit të fushës profesionale që programi i studimit përfshin.

Ref: Evidenca 13.2 Raporti i NJBSC

Ref: Evidenca 6.4 Anketa e Stafit

Ref: Evidenca 9 Mbledhje e Asamblesë së Personelit

Ref: Evidenca 11.3 USIA roundtable

Ref: E 12 Sondazhi Alumni.pdf


Ref: E 15 Formularet e vlerësimit Studente.pdf

Ref: Evidencë 16 Fokus Grupe,

Ref: Evidencë 17 Tutoriatet/ këshillim akademik

Konkluzione

- *KPT ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme, për sigurimin e cilësisë së Institucionit dhe të programit të studimit.*
- *KPT ka ngritur Njësine e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë që së bashku me strukturat hierarkike organizative, punojnë për sigurimin e brendshëm të cilësisë.*
- *Vlerësimi për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor për stafin akademik realizohet: nga vëzhgimi i leksioneve të hapura, vlerësimi i studentëve, nga vlerësimi i drejtuesit të departamentit, rezultatet nga aktiviteti shkencor i tyre, etj. Promovimi i stafit bëhet edhe me përfshirjen në projektet ndërkombëtare siç janë Erasmus + CBHE dhe në hartimin e*



legjislacionit të fushës profesionale që programi i studimit përfshin.

- KPT i është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin e parë dhe periodik institucional sikurse dhe të programeve të studimit.

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|--|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> | <p>Sipas RVB, dokumentave në DVV rezulton se programi TAK është organizuar në përputhje me kërkesat e “Kartës së Bolonjës”, duke përfshirë lëndët teorike, të harmonizuara me lëndë të formimit profesional.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacionin e DVV konstaton se programi i studimit me karakter profesional “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” është i organizuar në lëndë/module dhe aktivitete formuese, leksione, ushtrime, laboratore, të vlerësuara me kredite dhe të ndara në dy vite akademike, 4 semestra, me 120 kredite (ECTS) në total. Kategoritë e veprimtarive formuese kanë ndryshime të vogla në raport me VKM 879/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41/2018”, Tabela 1.1:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A (Lëndë bazë) - 3 lëndë, 13% (sipas VKM përmban 10-15%); - është në rregull; • Kategoria B (Lëndë karakterizuese) - 9 lëndë, 45%; (sipas VKM përmban 45-55%), pra është në rregull; • Kategoria C (Lëndë ndërdisiplinore/integruese/lëndë me zgjedhje) - 4 lëndë/module 22%; (sipas VKM përmban 5-15%), pra ka më tepër kredite; • Kategoria D (Lëndë plotësuese) - 3 lëndë 17%; (sipas VKM |

| | |
|--|--|
| | <p>përmban 10-15%), pra ka më <i>tepër</i> kredite;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria E (Detyrime përmbyllëse) - Provim diplomimi 6% (sipas VKM përmban 3-5%), pra ka më <i>tepër</i> kredite <p>Nga krahasimi i Tabelës së Kategorive të Veprimtarive Formuese (A-E) dhe syllabuseve ka pasaktësi/mospërputhje në lëndët:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) <i>Vizatim teknik dhe AutoCAD</i> - në syllabus B, në Tabelë A 2) <i>Termoteknikë e aplikuar</i> - në syllabus A, në Tabelë B; 3) <i>Mekanika e aplikuar</i> - në syllabus B, në Tabelë C 4) <i>Diagnostikimi i sistemeve HVAC</i>-në syllabus D, në Tabelë C; 5) <i>Hyrje në teknologjinë e informacionit</i> - në syllabus B, në Tabelë D; <p>Rregullimi i pasaktësive do ndryshonte edhe % e grupeve A-E, duke i sjellë sipas kërkesave të VKM nr. 879, datë 18.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga IAL-të”</p> <p>Lëndët e këtij programi kanë 4 deri 6 kredite (ECTS), provimi i përgjithshëm përfundimtar ka 7 kredite.</p> <p>KPT pasi lexoi Draft Raportin, deklaroi se janë korigjuar/plotësuar të gjitha vërejtjet e mësipërme të kriterit 1.</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK Ref: Tabelat 1-24 Ref: Evidenca 5.5 SYLLABUS.pdf</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p> | <p>Programi i studimit TAK synon të formojë teknikë të lartë që kanë të formuar aftësi dhe shprehje në ndërtimin, montimin, mirëmbajtjen e sistemeve HVAC. Programi i pajis studentët me njohuri e aftësi praktike teknike në fusha të ndryshme të impianteve për ngrohje, ftohje dhe ajër të kondicionuar, asistencën në projektim, operimin dhe në mirëmbajtjen e sistemeve mjedisore të HVAC, kaldajat, kondicionerët, pajisjet ftohëse industriale dhe laboratorike, etj.</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit TAK.pdf Ref: Evidenca 18 Vizita / Praktika në Terren Ref: Evidenca 20 - KPT HUB Ref: Evidenca 21 - Trajnime student Ref: Evidenca 11.3 USIA</p> |
| <p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të</p> | <p>Sipas RVB dhe Rregullores së programit të studimit, programi me karakter profesional 2-vjeçar “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” ka të përcaktuara objektivat dhe mundësitë për punësim. Në nenin 5 të Rregullores së programit të studimit</p> |



fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.

përcaktohen "Objektivat e programit të studimit", të cilat të detajuara shkruhen edhe në RVB, [cit]:

Programi i studimit "Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi" përgatit specialistë në zbatimin e metodologjive në fushën e projektimit, zbatimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve HVAC. Programi synon ta pajisë studentin me:

- *Njohuri të thella tekniko-shkencore të nivelit të lartë, që kërkohen në impiantet e ngrohjes, ftohjes dhe ajrit të kondicionuar;*
- *Aftësimin për përzgjedhjen instalimin, dhe mirëmbajtjen e sistemeve mjedisore për sektorin e banesave dhe komerciale;*
- *Aftësi të qëndrueshme dhe njohuri për projektimin, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve mjedisore të ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar dhe ftohjes (HVAC-R);*
- *Aftësi për të ndihmuar teknologët në projektimin e sistemeve të ndërtesave duke llogaritur rrjetin, duke krijuar planimetritë dhe vizatimet me ndihmën e kompjuterit;*
- *Aftësi praktike duke punuar në kaldaja, kondicionerë dhe pajisje të tjera në laboratore;*
- *Njohuritë për instalimet elektrike;*
- *Vënien në punë, montim, riparim dhe shërbime të sistemeve HVAC.*

Në nenin 6 jepen edhe mundësitë e punësimit:


- *Në zyrat e projektimit/menaxhimit të sistemeve HVAC;*
- *Në sektorët e ndërtimit të banesave dhe ambienteve tregtare;*
- *Në fushën e riparimeve, ndërtimit të automjeteve të lehta dhe të rënda;*
- *Në laboratorë, industrinë ushqimore, në mësimdhënie, profesionist i lirë.*

Mbi bazën e DVV dhe intervistave me studentët, GVJ konstatoi se aplikimi në praktikë i njohurive dhe aftësive të fituara realizohet përmes laboratorëve dhe praktikave pranë subjekteve pritëse dhe nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete si klubet studentore, trajnime, pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare. Objektivat e programit të studimit dhe mundësitë e punësimit publikohen në faqen e internetit të KPT, broshurat informuese, etj.

Ref: Evidenca 4 Rregullorja KPT

CEVY shkaq

| | |
|---|---|
| | <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit TAK, Ref: Evidenca 46 Broshura KPT</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p> | <p>GVJ mbështetur në dokumentacionine DVV konstaton se Programi i studimit me karakter profesional “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, i referohet nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë Profesionale” në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” në Kolegjin Profesional të Tiranës.</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit TAK dhe në planin mësimor janë të përcaktuara ngarkesa në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Të gjitha lëndët/modulet janë të shprehura në kredite që janë nga 4-7 kredite. 1 kredit ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. Kategoritë e veprimtarive formuese jepen në Kriterin 1, të këtij standardi.</p> <p>Në program janë parashikuar kredite për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione 49 ECTS • Ushtrime/ Seminare 37 ECTS • Laboratorë / Praktika 17 ECTS • Praktikë profesionale 10 ECTS • Provim përfundimtar 7 ECTS <p>Në të dhënat e mësipërme raporti është 42% : 58%. (leksione 49 Kredite+PP 1 Kredit) / (usht 37 Kredite+Prakt Prof 10 Kredite+laborat 17 Kredite+ PP 6 Kredite). GVJ mendon se kjo ndarje është pozitive dhe afërsisht plotëson kërkesat për një raport 50:50 të teorisë me praktikën. Por raporti i orëve përkatëse nuk është i tillë (shih më poshtë).</p> <p>Nga takimi me stafin akademik u theksua se punohet për të realizuar ciklin “informacion – njohuri – dije – aftësi”. Pra, synohet të arrihet formimi teorik dhe profesional i studentëve, ku niveli më i lartë është aftësia dhe kompetenca për të realizuar profesionin.</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit, neni 7 Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK</p> |
| <p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen</p> | <p>KPT nuk ka status të veçantë</p> |



në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.

GVJ nuk gjeti dokumentacion referues që të shprehet për këtë kriter. Edhe në RVB është përcaktuar përgjigja NA.

Nga komentet e KPT GVJ u informua për të gjithë rrugën e hartimit dhe ecurisë së këto programi, si më poshtë

KPT është themeluar në vitin 2015, duke qenë një pioner i arsimit profesional të lartë në vend. Në kohën e hapjes së KPT, nuk kishte asnjë IAL e tipit kolegji profesional i lartë. Hapja e KPT ishte një risi në vend në tregun e arsimit të lartë, e bazuar në përvojën më të mirë europiane. Hapja e KPT nuk ishte rastësore por erdhi si rezultat i një punë të gjatë kërkimore në rajon dhe në gjerë në lidhje me arsimin dhe programet e ngjashme që ofroheshin.[...] Grupi nismëtar kreu vizita në Greqi, (në kolegjet e ngjashme IEK si Delta etj), u konsultua me modelin gjerman, të arsimit profesional, me ekspertë vendas dhe të huaj, për të arritur në ofertën e parë akademike me 9 programe studimi, [...].

Gjithashtu një tregues për vlerën dhe cilësinë e këtij programi studimi është përqindja e lartë e punësimit të studentëve të tij, dhe si vlerë e shtuar dhe praktikave të studentëve në vende të ndryshme të Bashkimit Europian. Si i tillë, mendojmë se ky program vjen si një program pioner, që në këto vite është përmirësuar në vijimësi duke reflektuar trendet e teknologjisë dhe inovacionit, dhe për sa më sipër, mendojmë se i takon të shërbejë si referencë praktike e mirë në vazhdim për t'u ndjekur nga të tjerët. Në dijeninë tonë, nuk ka programe me të njëjtin emër, por janë vetëm dy programe që i përkasin fushës: "Specialist i sistemeve të kondicionimit" (UAMD) dhe "Sistemet e Ajrimit të Kondicionuar" (KPGJT).

Gjithashtu bazuar në pikën 6, Neni 86 "Kodifikimi i programeve të studimit", të Ligjit 80/2015. Këshilli i Ministrave dhe Ministria përgjegjëse për arsimin kanë hartuar aktet nënligjore përkatëse edhe në bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH, është vënë në zbatim procesi i kodifikimit të programeve, për të cilat KPT i ka aplikuar përkatësisht. Si rezultat i këtij procesi, vihet në zbatim kriteri ligjor që lidhet me përafrimin e programeve të fushave të ngjashme me të njëjtën emërtesë, duke patur si element dallues kodin përkatës. Ashtu si është evidentuar në Raport: Rezulton se është bërë edhe kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional TAK, mbështetur në Udhëzimin e MAS, nr. 31 datë 15.11.2022. Kodi

| | |
|--|--|
| | i këtij programi studimi është 52-PP/S-713 |
| Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | GVJ, sipas RVB dhe planit mësimor konstaton se është bërë edhe komunikimi me MAS. Për kodifikimin e lëndëve në planin mësimor GVJ konstaton se është ndjekur numri i fushës specifike të lëndës, p.sh.: <i>për lëndët specifike të lëndëve HVAC është vendosur i njëjti kod 713.</i> Përsa më sipër GVJ gjykon se KPT e ka përmbushur si kërkesë Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK; Evidence 8 Shkresa MAS për kodifikimin e programeve |

Konkluzione

- *GVJ konstaton se programi i studimit "Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi" organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, si në formë ashtu edhe në përmbajtje.*
- *Janë zbatuar kërkesat e Sistemit të Bolonjës, ku lëndët modulet janë shprehur në kredite/orë për kredite. Lëndët janë organizuar në disa forma mësimdhënie si: leksione, ushtrime, seminare, laboratore, praktikë profesionale, etj.*
- *GVJ sugjeron rregullimin e pasaktësive në përcaktimin e tipit të lëndës duke përputhur syllabuset dhe veprimtarive (A-E), sipas VKM 879/2019. Nga përgjigja e KPT rezulton se këto pasaktësi janë rregulluar.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X |

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Bazuar në RVB, Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit "Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi" është Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara. Ajo është Njësi bazë edhe për 4 programe të tjera 2 vjeçare. <ul style="list-style-type: none"> - Teknologji ndërtimi - Gjeodezi - Teknologji ajrimi dhe kondicionimi - Elektro-Mekanikë dhe grupon disiplina mësimore trajnuese të përafërta. GVJ për vlerësimin e këtij kriteri ju referua të dhënave tabelore të deklaruara në DVV, nga të cilat rezulton se: Njësia |



bazë DEMSA plotëson kriterin ligjor të numrit total se ka në përbërje 9 PAE (numri minimal është 5), dhe plotëson numrin minimal të PAE që kanë tituj/grada sepse ka 2 PAE me titullin Prof. Dr. (numri minimal është 1)². Pjesa tjetër e stafit është asistent-lektor me Msc. Të dhënat e departamentit sipas viteve akademike paraqiten si më poshtë:

| Tituj/ grada | 2020-2021 | | 2021-2022 | | 2022-2023 | |
|---------------|-----------|----------|-----------|----------|-----------|----------|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr. | 2 | - | 2 | - | 2 | - |
| Prof. Asoc. | - | - | - | 1 | - | - |
| Dr./PhD. | - | - | - | - | - | - |
| Msc. | 7 | 5 | 8 | 2 | 7 | 6 |
| Bsc | - | - | | 1 | - | - |
| Totali | 9 | 5 | 10 | 4 | 9 | 6 |

KPT është institucion i akredituar me VBA nr. 66, datë 21.09.2017; dhe është riakredituar periodikisht me VBA nr.8, datë 27.01.2023.

Akreditimi i parë i programit të studimit TAK është bërë me Vendim të Bordit të Akreditimit VBA nr. 82, datë 21.09.2017, “Për akreditimin e parë të programit të studimit 2 vjeçar me karakter profesional, pas arsimit të mesëm në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” për një afat 6 vjeçar. Në këtë vendim janë dhënë edhe rekomandime.

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve të programit të studimit.

Ref: Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite

Ref: Vendim të BA nr.82, datë 21.09.2017

Ref: VBA Nr. 66, datë 21.09.2017; VBA nr.8, datë 27.01.2023

Ref: Evidenca Urdhri nr. 16, datë 8.5.2023 “Për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të akreditimit periodik të programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për

Në RVB, dhe nga takimet me drejtuesit e institucionit u deklarua se KPT dhe njësia bazë DEMSA bashkërendojnë punën e tyre me stafin administrativ si stafin e sekretarisë mësimore për realizimin sa më efikas të proceseve të ndryshme brenda departamentit. Departamenti ka në

² VKM Nr. 370, datë 26.4.2017 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË” Neni 5.

| | |
|---|--|
| <p>realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p> | <p>dispozicion laboratorë, si dhe ofiçina për realizimin e praktikave mësimore. Në tabelën përmbledhëse të stafit si edhe gjatë takimeve u deklarua se stafi ndihmës akademik (laborantët) janë vetë pedagogët që realizojnë lëndët dhe orët përkatëse laboratorike.</p> <p>Ref: Tabela TA TAK.pdf Ref: Evidenca 22 Laboratorët Ref: Evidenca 20 - KPT HUB</p> |
|---|--|

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> | <p>Sipas RVB, GVJ konstatoi se Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, si njësi bazë për programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit dhe praktikave profesionale ka caktuar një pedagog si koordinator, person përgjegjës për ndjekjen e studentëve në praktikat profesionale. Gjithashtu për ecurinë dhe zhvillimin e praktikave profesionale në mbështetje të Departamentit është dhe Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve. GVJ konstaton në rolin e koordinatorit të programit është drejtuesi i departamentit, me shumë eksperiencë menaxhimi, që i realizon detyrat lidhur me ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit në përputhje me objektivat e programit të studimit TAK.</p> <p>Ref: Evidenca 3 Statuti KPT.pdf</p> |
|---|---|


Konkluzione

- *GVJ konstaton se Kolegji Profesional i Tiranës dhe Njësia bazë, Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, përgjegjëse për programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”-i përmbushin plotësisht kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Departamenti në vitin akademik 2022-2023 ka në përbërje 9 PAE nga të cilët 2 me tituj dhe 6 PAK me kualifikimin Msc.*
- *GVJ konstaton në rolin e koordinatorit të programit është drejtuesi i departamentit, me shumë eksperiencë menaxhimi, që i realizon detyrat lidhur me ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit në përputhje me objektivat e programit të studimit TAK.*
- *GVJ konstaton që nuk ka personel ndihmës akademik të dedikuar përgjegjës për një apo më shumë laboratorë, për të plotësuar më mirë kërkesat e programeve profesionale, në të cilat orët praktike janë shumë të rëndësishme, kjo veprimtari mbulohet nga pedagogët me eksperiencë të gjatë praktike në fushën e automjeteve.*

| | | | | |
|---|----------------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi II.3


Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në



përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.


| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Mbështetur në DVV, RVB si dhe takimet me drejtuesit e Programit të studimit, GVJ mori të gjithë informacionet e nevojshme, për të gjithë elementët e programit të studimit: organizimin, përmbajtjen dhe strukturën e tij. DEMSA mban të gjithë dokumentacionin e kurrikulës si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”; • Planin mësimor; • Syllabuset lëndore, të cilat janë hartuar sipas modeleve të kërkuara nga aktet ligjore, përsa i përket elementeve përbërës; • Rregulloren e praktikës profesionale; • Rregullore e punëve laboratorike; • Udhëzime për provimet, etj. <p>I gjithë informacioni në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit, gjenden të publikuara në folderin elektronik <i>Dokumenta KPT</i>. Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin edhe në faqen e internetit të KPT https://kolegji-profesional.edu.al/teknologji-automjetesh/</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK Ref: Evidenca 50 Programi dhe Model teze PPP</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p> | <p>GVJ konstaton se Plani mësimor i programit të studimit TAK është i plotë, me të gjithë informacionin për semestrat, orët mësimore të çdo lëndë/moduli, të ndarë sipas formave të mësimdhënies si dhe të ndara në orë mësimore në auditor dhe në orë të punës individuale të studentit. Pra:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mendojmë se Plani mësimor është i plotë dhe shumë i detajuar; • Gjithashtu plani mësimor ka të detajuar ndarjen në orë në auditor/orë jashtë auditorit për çdo lëndë dhe brenda lëndës për çdo formë mësimdhënie; • Këto të dhëna detajohen edhe në syllabuse dhe rregulloren e programit të studimit. <p>Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK Ref: Tabelat 1-24</p> |

| | |
|---|---|
| | https://kolegji-profesional.edu.al/teknologji-ajrimi-dhe-kondicionimi/ |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> | <p>Kriteret e pranimit në KPT miratohet me vendim të Senatit Akademik, depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe publikohen rregullisht në faqen e internetit të KPT dhe në rrjetet sociale të KPT. Informacionet e plota për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve jepen në Nenin 2 të Rregullores së programit të studimit dhe në nenet 24 e 31 të Rregullores së KPT, në Statutin e KPT, si edhe në faqen e internetit të KPT.</p> <p>Pranohen për t'u regjistruar pranë KPT të gjithë ata kandidatë të cilët:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kanë aplikuar në Portalin e Maturës Shtetërore dhe janë shpallur fitues në programin e përzgjedhur të studimit; 2. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë shtetit, së bashku me listën e notave (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë); 3. Kryejnë pagimin e tarifës së studimit sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës përkatëse mes KPT dhe studentit; 4. Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e Kontratës së studentit midis tij dhe KPT; 5. Në programet e studimit pranohen për t'u regjistruar shtetas shqiptarë ose të huaj. <p>Në nenin 2 të rregullores janë vendosur kriteret e përgjithshme për kandidatët që regjistrohen në këtë program studimi, [cit]:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kandidati duhet të ketë mbaruar "Maturën shtetërore"; 2. Kandidati mund të ketë një diplomë nga institucione jashtë vendit, që njihet dhe është e ekuivalentuar sipas legjislacionit; 3. Kandidatët mund të ndjekin si një program të dytë profesional studimi. |
| | <p>Në RVB deklarohet se: Dokumentat si më lart vihen në dispozicion të studentëve dhe janë të shpalluara në ambientet e shkollës.</p> <p><i>GVJ rekomandon që të vihet si kriter specifik mbrojtja/njohja e gjuhës shqipe nga kandidatët që kanë diplomë nga jashtë</i></p> |




| | |
|--|---|
| | <p><i>Shqipërisë. (sepse gjuha e deklaruar e studimeve është shqip).</i></p> <p>Sipas RVB, parimet e pranimit të studentëve të rinj, bazohen në kriteret e detyrueshme ligjore, kapacitetet e KPT në infrastrukturë, burimet njerëzore, analizave të tregut të punës, ecurisë së programeve dhe punësimit të studentëve. Kuotat dhe kriteret e pranimit shqyrtohen dhe miratohen nga Senati Akademik, para fillimit të vitit akademik, dërgohen pranë organeve përkatëse, vendosen në portalin U-Albania si dhe bëhen publike e përditësohen në faqen e internetit të KPT. (shih: https://kolegji_profesional.edu.al/regjistrimi/)</p> <p>Nga vizita në sekretarinë mësimore GVJ konstaton se, pranimi i studentëve bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me aktet rregullatore dhe Statutin e KPT.</p> <p>Ref: Evidenca 3 Statuti KPT, neni 6 Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjike, Neni 8 - Të drejtat e KPT, Neni 45 - Pranimi i studentëve</p> <p>Ref: Evidenca 4 Rregullorja KPT</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit TAK https://kolegji_profesional.edu.al/teknologji-automjetesh/</p> <p>Ref: Evidenca 7.1 Strategjia 2015-2020</p> <p>Ref: Evidenca 7 Strategjia 2021 – 2025</p> <p>Ref: Evidenca 23 – Vendimet SA</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> | <p>Nga DVV dhe vizita në KPT, GVJ konstaton se, për secilën lëndë të programit të studimit janë hartuar programet lëndore (syllabuset). Ato janë hartuar në përputhje me formatet e miratuara në aktet ligjore. Në çdo syllabus ka detajet e nevojshme për kreditet/orët mësimore për leksionet, ushtrimet, orët e laboratorit, praktikën profesionale, apo detyrimet përmbyllëse, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Gjithashtu në syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit të studimit paraqitet informacion i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Syllabuset miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit.</p> <p><i>GVJ sugjeron korigjimin e disa pasaktësive në përcaktimin e kategorisë së lëndës në syllabus (A, B, C, D, E) që të përputhen me kategorinë në Tabelën e formave të mësimdhënies.</i></p> <p>Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK</p> <p>Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK</p> |

CEK shka



| | |
|---|---|
| | Ref: Tabelat 1-24 (faqja 6) |
| <p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p> | <p>Në rregulloren e programit përcaktohet qartë se kurrikula rishikohet me synim përmirësimin e vazhdueshëm, në fillim të çdo viti akademik. Në këtë proces merren në konsideratë kërkesat e tregut të punës, zhvillimi i teknologjisë, dhe i materialeve teknologjike. Nga pjesëmarrja në aktivitete intensive me biznesin, KPT synon që pedagogët të azhurnohen me dinamikën e trendeve ekonomike. GVJ konstatoi se Departamenti DEMSA ka bërë ndryshime në përditësimin e syllabusve, literaturës, infrastrukturës në dispozicion, duke u ndihmuar edhe nga projektet, si Erasmus + CBHE - “<i>Inxhinierizimi i modernizimit të kurrikulës së energjisë së rinovueshme në universitetit shqiptare</i>”, që trajnon stafin me konceptet e përmirësimit dhe përshtatjes së lëndës/ëve me metodat bashkëkohore të mësimdhënies³.</p> <p>Projekti synon modernizimin dhe ndërkombëtarizimin e kurrikulave për Energjitë e Rinovueshme nëpërmjet inovacionit të kurrikulave në përputhje me zhvillimet në rajon dhe kërkesat e tregut të punës, nisur nga fakti që përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe përmirësimi i efikasitetit të energjisë siguron një ekonomi të qëndrueshme bazuar në kushtet e zhvillimit shkencor. KPT ndërtoi një laborator të ri ndërdisiplinor, si dhe bëri përditësimin e përmbajtjes së lëndës “Bazat e ngrohjes dhe sistemet ngrohëse”.</p> <p>Ref: Evidence 5 - Strategjia e Zhvillimit 2021- 2025 https://engineproject.eu/</p> |
| <p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> - GVJ konstaton se Programi i studimit TAK është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional. - Në syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit të studimit paraqitet informacion i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Syllabuset miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit. <u>GVJ sugjeron korigjimin e disa pasaktësive në përcaktimin e kategorisë së lëndës në syllabus (A, B, C, D, E) që të përputhen me kategorinë në Tabelën e formave të mësimdhënies.</u> - GVJ konstatoi se Departamenti DEMSA ka bërë ndryshime në përditësimin e syllabusve, literaturës, infrastrukturës në dispozicion duke u ndihmuar edhe nga projektet, si Erasmus | |

³ Erasmus + CBHE - Engineering curricula modernization in renewable energy in Albanian Universities” ENGINE, është një projekt ku marrin pjesë 11 partnerë nga Shqipëria, Turqia, Belgjika etj. të udhëhequr nga Universiteti Politeknik i Tiranës.



+ CBHE etj , që trajnojnë stafin me konceptet e përmirësimit dhe përshtatjes së lëndës/ëve me metodat bashkëkohore të mësimdhënies.

- GVJ sugjeron që të vihet si kriter specifik mbrojtja/njohja e gjuhës shqipe nga kandidatët që kanë diplomë nga jashtë Shqipërisë.

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X | |


Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p> | <p>GVJ konstaton se emërtimi i lëndëve apo moduleve në përgjithësi është në përputhje me përmbajtjen e temave që përmban lënda. Çdo lëndë ka objektivat e saj, që duhen arritur deri në përfundim të saj. Objektivat lëndore synojnë objektivat për të gjithë programin. Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave dhe e praktikës profesionale në fund të semestrit të dytë në vitin e dytë, tenton drejt thellimit të njohurive dhe rritjes së kompetencave dhe aftësive profesionale të studentëve. Pra ka një shpërndarje pa mbingarkesë për studentët.</p> <p>Ndërthurja e njohurive teorike (leksione) me ato praktike (ushtrime, laboratorë, praktika mësimore, etj) i jep të diplomuarit në këtë program studimi kompetenca profesionale të mjaftueshme për t'u punësuar si teknikë të kualifikuar në tregun e punës, vendas e të huaj. Të diplomuarit në programin e studimit Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” fitojnë kompetenca profesionale për t'u punësuar në fushën e projektimit, ndërtimit, shërbimit, riparimit dhe testimit të sistemeve të ngrohjes, ftohjes, ventilimit, kondicionimit të ajrit (HVAC) ose si menaxher tregtar dhe konsulent shitjesh të pajisjeve të këtyre sistemeve, që i gjejmë në sektorët e:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërtimit të banesave dhe ambienteve tregtare; - menaxhimit të pajisjeve HVAC; - shërbimit të sistemeve HVAC tek automjetet e lehta dhe të rënda; - industrisë ushqimore. <p>Gjithashtu i diplomuari mund të punojë</p> <ul style="list-style-type: none"> - në laboratorët shkencorë, në mësimdhënie, |

(Ely shleg)


| | |
|--|--|
| | <p>- si profesionist i lirë në fushën e tregtisë dhe mirëmbajtjes të pajisjeve HVAC, në tregun e punës, vendas e të huaj.</p> <p>Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK</p> |
| <p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p> | <p>GVJ konstaton se tërësia e lëndëve që përbëjnë kurrikulën synon arritjen e objektivave të programit të studimit TAK dhe formimin profesional të studentëve. Çdo lëndë është vlerësuar me kredite dhe orë, ku 1 kredit është baraz me 25 orë punë të studentit, e ndarë në punë në auditor dhe punë individuale jashtë auditorit. Çdo vit ka dy semestra dhe çdo semestër ka 15 javë mësimore. Shpërndarja e lëndëve është bërë e tillë që lëndët, njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që fitohen të jenë në vijimësi të njëra-tjetrës. Shpërndarja e 120 krediteve në total, është me 60 kredite për çdo vit akademik. Në vitin e parë janë vendosur lëndët e formimit bazë dhe karakterizuese të profesionit. Ndërsa vitin e dytë përveç atyre të tipit B, ka lëndët e tipologjisë C (si lëndë integruese/me zgjedhje), D-praktika profesionale dhe E-provimi përfundimtar/ diplomimi.</p> <p>Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK</p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> | <p>Nga analiza e planit mësimor dhe tabelës së ndarjes së lëndëve sipas veprimtarive formuese (A-E), GVJ mendon se programi synon arritjen e objektivave nëpërmjet formimit teorik të harmonizuar me atë praktik, nëpërmjet laboratorëve, detyrave të kursit, apo praktikave dhe punëve konkrete.</p> <p>Konkretisht nga plani mësimor i programit TAK rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Orë Leksione 343 orë • Orë Ushtrime 444 orë • Orë Praktika lëndore/Laboratorike 356 orë • Orë Praktika Profesionale 210 orë • Orë të provimit përmbyllës (diplomimit) 12 orë • Orë gjithsej në auditor 1365 orë <p>Në RVB jepet një analizë dhe raport ku ushtrimet/seminaret konsiderohen orë teorike dhe rezultojnë që: teoria (orë leksioni + orë ushtrimesh) / praktika (orë laboratorësh+ orë të praktikës profesionale), në raportin e vetë institucionit del 58% me 42%. <i>GVJ konstaton se raporti teori/praktikë është afërsisht</i></p> |



| | |
|---|--|
| | <p>50%:50%, në përputhje me profilin e programit të studimit si një program jouniversitar 2-vjeçar me karakter profesional⁴.</p> <p>Nga ana tjetër GVJ mendon se kriteri që “Rreth 25% e programit studimi i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion” është arritur (210 orë praktikë direkt në profesion i shtohen orët e praktikës laboratorike të lëndëve të lidhur direkt me profesionin (179 orë⁵) krahasuar me 1365 orë gjithsej në auditor -rezultojnë rreth 29%).</p> <p>Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK Evidence 18 - Vizita ne terren</p> |
| <p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>GVJ konstaton se në programin e studimit me karakter profesional në “TAK” ndarja sipas veprimtarive formuese, (A-E) krijojnë mundësinë për një formim të plotë të studentëve, në përputhje me objektivat formuese të tij. Ndërtimi i programit sipas parimeve të Bolonjës, u mundëson studentëve transferimin e studimeve nga dhe në institucione të tjera.</p> <p>KPT ka ngritur disa laboratorë dhe ofiçinë ku studentët krahas njohurive teorike, realizojnë orët praktike, formohen individualisht dhe në grup për aftësitë dhe shkathtësitë që nevojiten në profesion. Për mirëfunksionimin e tyre është ngritur edhe Këshilli i Sigurisë në zbatim të “Kodit të Punës”, Ligjit 9634 dhe Ligjit 10237, për sigurinë në punë. Nga takimet me studentët dhe me përfaqësues të Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve tregojnë për të dhëna shumë të mira të punësimit të studentëve të këtij programi studimi. Sipas RVB përqindja e të punësuarëve është në nivelin 80%, ku një pjesë e studentëve janë punësuar që gjatë praktikave profesionale 6-javore. Krahas mundësisë për punësim studentët janë pjesë e mobiliteteve në vendet e BE-së falë projekteve europiane ku KPT merr pjesë.</p> <p>Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK; Ref: Evidenca 6 Te dhenat e Studenteve ne vite.pdf Ref: Evidenca 18.1 Panairi i punës ne KPT</p> |

⁴ Megjithatë, nëse orët e ushtrimeve të lëndëve bazë teorike (222 orë) i bashkëngjiten orëve teorike të leksioneve, ndërsa orët e ushtrimeve të lëndëve profesionale (222 orë) i bashkëngjiten orëve laboratorike dhe orëve të praktikës profesionale (513 orë), rezultati bëhet: 577 / 788 (orë) dhe raporti del 42% orë teorike / 58% orë praktikë, pra GVJ konstaton se raporti teori / praktikë është afërsisht 50%:50%, në përputhje me profilin e programit të studimit si një program jouniversitar 2-vjeçar me karakter profesional.

⁵ Këtu janë futur lëndët: Bazat e ftohjes dhe sistemet ftohëse; Bazat e ngrohjes dhe sistemet ngrohëse; Ajri i kondicionuar dhe sistemet e tij; Teknikë gazi; Sistemet e shpërndarjes së ajrit të kondicionuar/ Ventilimi; Kontrolli në sistemet HVAC dhe të ftohjes; Diagnostikimi i sistemeve HVAC.



| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p> | <p>Ref: Evidenca 21/1 Mobilitetet</p> <p>Mbi bazën e RVB dhe DVV, GVJ konstaton se programet e lëndëve (syllabuset) janë objekt i diskutimeve për përditësimin e tyre duke u bazuar në literaturën e detyruar dhe ndihmëse të viteve të fundit, (u deklarua se synohet literatura bashkëkohore e 5 viteve të fundit). Syllabuset rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, dhe miratohen nga Drejtuesi i departamentit. Bashkëpunimi dhe mundësia e aksesit në biblioteka online, mundëson përditësimin e vazhdueshëm të literaturës. GVJ u interesua në bibliotekë nëse literatura e rekomanduar është pjesë e bibliotekës dhe rezultoi që në të gjitha rastet ato janë në departamet, ose në bibliotekë.</p> <p>GVJ konstaton se krijimi i bibliotekës on-line, mobiliteti i stafit akademik në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, kanë reflektuar edhe në punën për përmirësimin e syllabuseve.</p> <p>Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK Ref: Evidenca 11 Lista e Projekteve Ref: Evidence 11.1 Ëorkshop Online USIA MOVET Ref: Evidence 11.2 MOVET Design Thinking Ëorkshop</p> |
| <p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p> | <p>GVJ konstaton se bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i /përvoja praktike, është saksionuar në Rregulloren e programit të studimit TAK. Mentorimi i praktikës bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Praktikave Profesionale, e sipas dokumentacioneve shoqëruese për të.</p> <p>GVJ evidenton se është paraqitur në DVV tabela me marrëveshjet me punëdhënësit, ku studentët bëjnë praktikën.</p> <p>Sipas RVB, në KPT është ngritur Zyra USIA [cit]: <i>si një sistem efikas mbështetës për zgjerimin e rrjetëzimit të KPT, bashkëpunimin në kuadër të Heliksit të Katërfishtë: academia-biznesi-politikëbërja-shoqëria civile (Quadruple Helix), kërkimin dhe transferimin e njohurive, inovacionin dhe aplikimin e teknologjive të reja.</i></p> <p>Në KPT funksionon sistemi i tutoratit ku pedagogët ndihmojnë studentët në qartësimin e ideve, i ndihmojnë të kapërcejnë vështirësitë që paraqet arsimi i lartë dhe i inkurajojnë që të përfitojnë nga mundësitë për punësim.</p> <p>Ref: Evidenca 17.1 Rregullore Tutoriati Ref: Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale Ref: Evidenca 5.2 Raporti i praktikave Ref: Evidenca 5.4 Dosja e praktikave Ref: Evidenca 33 Lista e partnerëve/marrëveshjeve të bashkëpunimit</p> |

(Signature)

Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.

Përmbajtja e programit të studimit TAK u mundëson studentëve përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale, që synon formimin e teknikëve të lartë në fushën e HVAC. Programi i studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” hyn në programet e suksesshme profesionale të KPT, si program i preferuar. Kompetencat/aftësitë e synuara të të diplomuarve janë:

- *Aftësi për përzgjedhjen, instalimin, vënien në punë, riparimin, shërbimin, mirëmbajtjen e sistemeve HVAC, për sektorin e banesave dhe ndërtesave komerciale;*
- *Aftësi teknike në ndihmë të inxhinierëve në projektimin e sistemeve mjedisore të ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar dhe ftohjes (HVAC-R) të ndërtesave, duke llogaritur rrjetin, duke krijuar planimetritë dhe vizatimet me ndihmën e kompjuterit.*
- *Aftësi praktike duke punuar në kaldaja, kondicionerë dhe pajisje të tjera në laboratore.*

Nga takimet me studentët GVJ konstatoi se një pjesë e tyre janë të punësuar “part time” në orare të cilat nuk pengojnë në vazhdimin dhe realizimin e procesit mësimor për ta. Edhe shkalla e punësimit pas studimeve është e lartë. Si pjesë e praktikave organizohen vizita në terren të studentëve në biznese, industri, për të parë nga afër, njohur dhe familiarizuar me procese pune, procedura, etj, si dhe me vetë ambientin dhe kulturën e punës. KPT ka në organigramën e saj prej disa vitesh Zyrën e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të studentëve që ndjek edhe të dhënat për punësimin e studentëve si një tregues i performancës së programit të studimit në treg. Nga takimi me përfaqësues të kësaj zyre GVJ mësoi se aty mbahet një databazë të dhënash për punësimin pas studimeve (sipas vetëdeklarimit të tyre), apo i jepet informacion këshillim karriere për punësimin e tyre. Sipas RVB, KPT e ka mbështetur përmirësimin e programit të studimit TAK si në vlerësimin/mendimin e avancuar pedagogjik ashtu edhe në mendimin e studentëve.

Ref: Evidenca 18 Vizita / Praktika në terren

Ref: Evidenca 5 Rregullorja e Programit të studimit TAK.pdf

Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK

Konkluzione

- *GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese të synuara dhe me nivelin 5 të KSHK.*
- *Rezultatet e të nxëniet, kompetencat e fituara në përgjithësi janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.*


- GVJ konstaton se raporti teori/praktikë është afërsisht 50%:50%, në përputhje me profilin e programit të studimit si një program jouniversitar 2-vjeçar me karakter profesional.
- GVJ mendon se kriteri që "Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion" është arritur dhe rezulton rreth 29%).

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X |

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p> | <p>Nga takimet me drejtuesit, GVJ konstatoi se KPT është anëtar në disa projekte me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm (universitete) ku në qendër është cilësia dhe studentët. Për këtë program studimi janë disa marrëveshje me aktorë të tregut të punës, ku krahas kryerjes së praktikave profesionale, ato shërbejnë edhe për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Edhe nga takimi me studentët, GVJ konstatoi se janë marrë parasysh propozimet e tyre.</p> <p>Nga DVV dhe RVB del se KPT organizon konsultime, fokus grupe apo pyetësor me synim azhurnimin me kërkesat e tregut të punës. Projekte të fituara ku KPT është partner: Jean Monnet Module, Erasmus + CBHE USIA, Erasmus + CBHE Engine, MoVET – EAC-2020-0863, Connected through mobility, ReZEB, Virtual exchanges in higher education and youth (EVE) ERASMUS-EDU-2022-VIRT-EXCH, V.I.R.TU.A.L. /101092478 - DLV-101092478. KPT ndërtoi një laborator të ri ndërdisiplinor, si dhe bëri përditësimin e përmbajtjes së lëndës "Bazat e ngrohjes dhe sistemet ngrohëse".</p> <p>Ref: Evidenca 9 Mbledhje e Asamblesë së Personelit Ref: Evidence 11.3 USIA roundtable/ USIA Ref: Evidence 5.7 RISHIKIM PROGRAMI ENGINE.pdf https://kolegijiprofesional.edu.al/portofoli-i-projekteve/</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në</p> | <p>GVJ në takimet me studentët dhe drejtuesit e departamentit u informua se KPT/DESMA ka përfshirë studentët në përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit në formën që çdo personel akademik me detyrë tutor, në fund të semestrit mbledh mendime/ sugjerime nga studentët. Këto i parashtron në mbledhjen e posaçme të departamentit. Përfshirja e studentit, si</p> |



| | |
|---|--|
| <p>ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p> | <p>anëtar i GVB është bërë me urdhër të Rektorit, si pjesë e këtij angazhimi. Në bazë të DVV, GVJ konstatoi se KPT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar, ku në qendër janë shqetësimi për kënaqësinë e tyre për programin, mjetet laboratorike, etj. Përfundimet e nxjerra e vlerësimet ndihmojnë në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Nga RVB dhe nga takimet e zhvilluara në KPT, rezulton se në kuadër të projektit Erasmus+CBHE “University to Society Innomediaries in Albania: Co-Production of knowledge and research that atters/U-SIA që financohet nga BE, u organizuan evente (focus groupe) me stafin, studentët, kërkues dhe partnerë në sektorët që lidhen me TAK, për të evidentuar marrëdhënien KPT - Biznes, përfshirë edhe punësimin.</p> <p>Ref: E 11.3 USIA roundtable USIA.pdf Ref: Evidenca 15 Formularët e vlerësimit Studentë Ref: Evidenca 16 Fokus Grupe Ref: Evidenca 17 Tutoriat këshillim akademik</p> |
| <p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private.</p> | <p>Gjatë viteve të ofrimit të këtij programi studimi që nga viti 2015, DESMA si njësia përgjegjëse për programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” ka punuar për përmirësimin dhe përshtatjen me zhvillimet e fundit në fushën e teknologjive të ngrohjes dhe ventilimit.</p> <p>GVJ, mbështetur në RVB dhe DVV, konstaton se KPT, me anë të pjesëmarrjes në projekte, evente, studimeve të tregut, kontaktet intensive me biznesin, synon të jetë i azhornuar me dinamikën e trendeve ekonomike, sociale dhe kërkesat e tregut të punës, në mënyrë që të reflektojë këto përkatësisht edhe në ofertën e tij akademike. Në kuadër të projektit MoVET - Mobility for VET in Europe - EAC/S54/2019 është zhvilluar takimi zyrtar për krijimin e një modeli “Go+Learn” në KPT. Go+Learn bazohet në praktikën e mirë të Partnerëve Europeanë, një nyje e cila forcon lidhjen dhe ndërveprimin midis akademisë, biznesit, dhomave të tregtisë, etj, në bashkëpunimin më efikas dhe efektiv mes tyre.</p> <p>https://www.linkedin.com/feed/update/urn:li:activity:7081919386495721472</p> |
| <p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>KPT dhe DESMA nxisin përfshirjen e studentëve, atyre alumni si dhe partnerëve të biznesit në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.</i> - <i>GVJ konstaton se programi është përmirësuar edhe me ndryshimet e ardhura si rezultat i</i> | |

| projekteve të BE, ku KPT dhe DESMA janë bashkëpunëtorë. | | | | |
|---|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1


Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> | <p>GVJ, bazuar në planin mësimor të programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, për vitin 2022-2023, konstaton se në program janë parashikuar orë mësimore në auditor /jashtë auditorit, për elementët e studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione 343 orë mësimore • Ushtrime 444 orë mësimore • Laboratorë/Praktikë 356 orë mësimore • Praktikë profesionale 210 orë mësimore • Provim diplomimi 12 orë mësimore <p>Gjithsej orë në auditor 1365 orë</p> <p>Gjithsej orë jashtë auditorit 1635 orë</p> <p>Praktika profesionale zhvillohet për 6 javë pranë organizatave, kompanive dhe bizneseve me të cilat KPT ka akt marrëveshje për bashkëpunim. Me vendim të Rektoratit nr. 20/1, 2023 është vendosur që në vend të provimit përfundimtar, studentët me mesatare mbi 8, mund të bëjnë punim diplome. Mendojmë se format e ndryshme të mësimdhënies e rrisin cilësinë e këtij programi studimi. Nga takimet me stafin akademik GVJ mësoi se krahas formave të mësipërme standarde të mësimdhënies lektorët mund të ftojnë në orën e leksioneve ekspertë të fushës si dhe të organizojnë vizita në biznese dhe praktika në terren. Sipas RVB dhe rregullores së programit, frekuentimi i orëve</p> |


(Elyshka)

[Signature]

| | |
|--|---|
| | <p>mësimore është i detyrueshëm në masën 75%.</p> <p>Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK Ref: Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit TAK.pdf Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK Ref: Evidenca 22 Laboratorët</p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> | <p>GVJ konstatoi se personeli akademik në përgjithësi i përgjigjen cilësisht nevojave të studentëve. Nga takimet me stafin akademik GVJ mësoi se krahas formave të mësipërme standarde të mësimdhënies lektorët mund të ftojnë në orën e leksioneve ekspertë të fushës si dhe të organizojnë vizita në biznese dhe praktika në terren. Në syllabuse janë parashikuar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. GVJ në takimin me personelin akademik konstatoi se për plotësimin e nevojave shtesë të studentëve bëhen edhe konsultime. Në procesin e mësimdhënies përdoren edhe mjetet audio vizive për seminare të veçanta apo seanca praktike shtesë.</p> <p>Në kuadër të projektit Erasmus + CBHE Engine (https://kolegji.profesional.edu.al/portofoli-i-projekteve/) është ndërtuar një platformë online ku ngarkohen materiale edukative në lidhje me lëndët mësimore (video, leksione, ushtrime të zgjidhura, ushtrime të pazgjidhura, etj) si një formë interaktive dhe moderne në ndarjen e informacionit dhe mësimdhënies. Është përgatitur dhe një platformë digjitale ku janë ngarkuar ushtrime të ndryshme. Në kushtet e mësimdhënies online, u shfrytëzuan përparësitë e teknologjisë. U përdor Microsoft Teams, një platformë e sigurt dhe interaktive, e unifikuar, duke mos lejuar përdorim platformash alternative, mundëson ngarkimin e materialeve, klasat, meeting online, bashkëbisedimin me studentët dhe ndjekjen e vlerësimit të tyre nëpërmjet detyrave dhe angazhimeve, raporte, regjistrim të klasës që mund të përdoret në një moment të dytë për mësimin asinkron, etj.</p> <p>Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK Ref: Evidenca 25 Mësimi Online-ZYRA IT video tutorial/manual https://kolegji.profesional.edu.al/meso-online/ Ref: Evidenca 17 TUTORIAT KESHILLIM AKADEMIK.pdf Ref: Evidenca 17.1 Rregullore Tutoriati.pdf</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënies, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p> | <p>GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, Departamenti DESMA/institucioni KPT ka vepruar si në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë, laboratorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies, etj; ashtu edhe nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme të stafit akademik në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur</p> |



| | |
|---|--|
| | <p>metodat e mësimdhënies.</p> <p>Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të procesit akademik, KPT ka realizuar një pyetësor, për të evidentuar nevojat për ndryshim dhe /ose përmirësim, për të ndarë me njëri tjetrin praktikën e mira, duke synuar përmirësimin e punës. Për forma inovative të mësimdhënies apo për përdorimin e laboratorëve ofrohen trajnime për stafin nga KPT, edhe nëpërmjet zyrës së IT apo ofruesve të pajisjeve apo projekteve. Kjo gjë u bë domosdoshmëri në fazën e parë të mësimin online ku u bë trajnimi i të gjithë stafit, së bashku me dhënien e manualëve. Nga dokumenti “Veprimtari të stafit në kuadër të projekteve-trajnimeve” GVJ mëson se janë organizuar veprimtari trajnuese të personelit akademik dhe administrativ, në: workshop-e, vizita studimore, evente, aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në kuadër të projekti MoVet në Tiranë, Itali, Greqi, Gjermani, Belgjikë dhe Turqi, etj.</p> <p>Ref: Evidenca 6.4 Anketa e Stafit Ref: Evidenca 6.2 Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve Ref: Evidenca 48 Artikuj Botime promo Libri.pdf; Ref: Evidenca 6.5 NASA Hackathon konkurse.pdf Ref: Evidenca 11 Lista e projekteve, Ref: Evidenca 46/1 Broshura Engine, Broshura USIA</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik të student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>Nga RVB deklarohet se <i>stafi i KPT është një aset me vlerë, një kombinim brezash e përvojash të shquara akademike dhe profesionistë të rinj të orientuar drejt praktikës.</i></p> <p>GVJ, mbështetur në DVV për punën shkencore të personelit akademik, në takimet me anëtarë të tij, si dhe në takimet me studentë konstatoi një staf që punon i angazhuar për dhënien e njohurive si dhe përgjegjshmëri për zhvillimin e lëndëve me cilësi. Personeli akademik i kushton rëndësi formave interaktive për të angazhuar sa më shumë studentët, ashtu si dhe puna individuale dhe ajo në grup. KPT nxiti organizimin e orëve të hapura si një formë e ndarjes së përvojës dhe praktikës në mësimdhënie.</p> <p>Ref: Evidenca 48 Artikuj, Botime, Promo libri Ref: Evidenca 46/1 Broshura Engine, Broshura USIA Ref: Evidenca 6.5 - NASA Hackathon / konkurse Ref: Evidenca 35 Praktika Connected through Mobility</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë</p> | <p>Në statutin dhe Rregulloren e KPT citohet se <i>Drejtuesi i departamentit miraton syllabusët e hartuara, bën vlerësimin e mësimdhënies, qoftë duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimin</i></p> |



| | |
|--|--|
| <p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p> | <p><i>nga personeli akademik, qoftë duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar, në mbledhjet e hapura me ta.</i></p> <p>Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, si njësi bazë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor edhe metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar. GVJ mendon se ky proces është pozitiv dhe rrit përgjegjsh-mërinë e të dy palëve, si të pedagogëve, por edhe studentëve. Një tregues i rëndësishëm që i jepet përmirësimit të mësimdhënies janë edhe projektet ku KPT është pjesëmarrës, dhe cilësia dhe metodat e mësimdhënies janë edhe fokusi i tyre.</p> <p>Ref: Evidenca 15 Formularët e vlerësimit Studentë Ref: Evidenca 16 Fokus Grupe Ref: Evidenca 17 Tutoriatet / këshillim akademik' Ref: Evidenca 12 Sondazhi Alumni.pdf</p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> | <p>GVJ, mbështetur në RVB e DVV, evidenton se është ngritur Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), si njësi autonome operative e përhershme në strukturën organizative të KPT. Sigurimi i brendshëm i cilësisë garanton cilësinë e veprimtarisë së institucionit (mësimdhënës dhe menaxherial), që të kryhen në përputhje si me dispozitat ligjore ashtu edhe në përputhje me vizionin, misionin dhe objektivat e KPT.</p> <p>Në rregulloren e NJBSC jepen objektivat e SBC:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi i vazhdueshëm i drejtimit dhe menaxhimit të institucionit; - Ndjekja e vazhdueshme programit të studimit, lëndëve rishikimi dhe përditësimi i tyre; - Ndjekja e nivelit të cilësisë së stafit akademik, kualifikimit të tyre, etj. <p>GVJ konstaton se NJBSC vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, formuese e trajnuese, si dhe të veprimtarisë administrative e financiare të KPT. NJBSC propozon tek Rektori ndryshime për përmirësimet e nevojshme, (sipas statutit të KPT). Për ushtrimin e funksioneve të saj, NJBSC-ja ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Njësia përbëhet nga Kryetari, nga anëtarë që përfaqësojnë çdo departament, personelin ndihmës – akademik ose administrativ, një përfaqësues nga jashtë institucionit si ekspert për çështje të vlerësimit, si dhe një anëtar përfaqësues nga Këshilli i</p> |

| | |
|--|--|
| | Studentëve, gjithsej përbëhet nga 6 anëtarë. Ref: Evidenca 13.1, Rregullore NjBSC Ref: Evidenca 13.2 Raporti NjBSC |
|--|--|

Konkluzione

GVJ konstaton se KPT dhe DEMSA punojnë për të garantuar:

- Cilësi në procesin e të nxënësve, nëpërmjet organizimit të mësimdhënies me forma të larmishme të mësimdhënies si: leksione, ushtrime, laboratorë, detyra, praktikë profesionale, etj. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75%.
- Kualifikimin profesional të personelit akademik, që të zbatojë metoda mësimdhënëse të avancuara, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve pozitive.
- Monitorimin e proceseve të mësimdhënies dhe promovimin nga strukturat përgjegjëse, që ngrihen nga DEMSA në bashkëpunim me Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Rezultatet janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve nga studentët dhe aktorë të tjerë të grupeve të interesit.


| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> | <p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve përcaktohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e KPT dhe Rregulloren e programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, në të cilat përcaktohen rregullat e provimeve, rregullat për ankimimin e notave, etj; • Syllabuset e lëndëve, ku në një rubrikë të caktuar ka të detyrueshme edhe mënyrën e vlerësimit të njohurive; • Rregulloren e sekretarisë (që sqarojnë rregullat për regjistrimet në provime, riprovime, etj). <p>Të gjitha rregullat bëhen publike dhe njihen nga studentët. KPT mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>Ref: Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale Ref: Evidenca 33 Rregullore e sekretarisë Ref: Evidenca 28.1 Sistemi Classter</p> |
| <p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>Nga intervista me studentët, [<i>takim me studentët, takim me stafin akademik</i>] nga RVB si dhe dosja VV, konstatohet se studentët marrin informacione të plota për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset nga titullari i lëndës/modulit. Informimi bëhet në fillim të vitit të parë dhe në fillim të çdo lëndë/moduli. GVJ konstatoi se ky informacion gjendet në Manualin e studentit, në sistemin Classter si dhe fizikisht në ambientet e shkollës. Informacioni sqarohet edhe gjatë Javës orientuese të fillimit të vitit akademik si dhe nga çdo pedagog për lëndën e tij përkatësisht.</p> <p>Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK Ref: Evidenca 27 Manuali i Studentit Ref: Evidenca 29 Java e Orientimit Ref: Evidence 28 Manuali Classter</p> |
| <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p> | <p>Në çdo syllabus janë vendosur si rubrikë e veçantë format e vlerësimit të studentëve. Vlerësimi i vazhdueshëm bëhet në këto forma: <i>me kolokiume, pyetje-përgjigje me gojë në orët e ushtrimeve, detyrë kursi, laboratore dhe provim përfundimtar.</i> Pesha që mban secili prej formave është në raportet 10/30/60, por çdo gjë varet edhe nga lënda. Kombinimi dhe pesha e këtyre komponentëve mund të ndryshohet në lëndë të caktuara, për t'iu përshtatur më mirë natyrës së lëndës.</p> <p>Nga rregullorja e programit të studimit, rregullorja e KPT, rezulton se provimi përfundimtar për lëndët mësimore bëhet me testim, që realizohet me procedurë sekretimi. Vlerësimi i testit bëhet me 100 pikë, ku vlera përkatëse konvertohet në notë. Notës kaluese më të ulët 5 (pesë) i korrespondojnë 41 pikë të fituara nga studenti (minimalisht).</p> <p>Në lidhje me praktikën profesionale, në përfundim të praktikës, studenti përgatit një raport përfundimtar për punën e kryer dhe përvojën në subjektin pritës, sipas dokumentacionit të përcaktuar në Rregulloren e praktikave profesionale, që mbrohet para një komisioni <i>ad hoc</i>. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet me sistemin e notave, 1-10, ku nota 5 (pesë) është notë kaluese minimale.</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit Ref: Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale Ref: Evidenca 5.2 Raporti i praktikës</p> |



Konkluzione

- GJV konkludon se KPT dhe DEMSA kanë hartuar a) rregulloren e programit të studimit TAK, b) rregulloren e sekretarisë, c) rregulloren e zhvillimit të praktikës profesionale si dhe d) syllabuset, ku përcaktohen procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale.
- Vlerësimi i vazhdueshëm bëhet në këto forma: me kolokiume, pyetje-përgjigje me gojë në orët e ushtrimeve, detyrë kursi, laboratore dhe provim përfundimtar.
- Në lidhje me praktikën profesionale, në përfundim të praktikës, studenti përgatit një raport përfundimtar për punën e kryer dhe përvojën në subjektin pritës.
- Gjatë vizitës GJV konstatoi se KPT garanton zbatimin e rregulloreve.

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X |

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | <p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë semestrit/vitit akademik dhe parashikohet në syllabuset e lëndëve/moduleve. Në çdo syllabus janë vendosur si rubrikë e veçantë format e vlerësimit të studentëve. Vlerësimi i vazhdueshëm bëhet në këto forma: me teste, pyetje-përgjigje me gojë në orët e ushtrimeve, detyrë kursi, laboratore dhe provim përfundimtar. Pesha që mban secila prej formave është ndarë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Aktivizimi në ushtrime 10 pikë- Kolokiume/detyra kursi/laboratorë/praktika 30 pikë- Provimi përfundimtar i lëndës 60 pikë <p>Shkalla e përvetësimit të dijeve, me shkrim dhe/ose me gojë, vlerësohet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë), dhe shprehet me germa nga F në A. Studenti lejohet të hyjë në provimin përfundimtar, kur ka shlyer të gjitha detyrimet që parashikohen në syllabus për punën që do të bëjë ai gjatë gjithë vitit.</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit, neni 8</p> |
| Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të | Në RVB theksohet që: Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në |

| | |
|--|--|
| <p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> | <p>sekretarinë mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Sistemi elektronik është përdorur në periudhën e Covid 19. Por GVJ nuk konstatoi se janë zhvilluar provime online dhe vlerësime të tyre online.</p> <p>Ref: Evidenca 27 Manuali i studentit</p> |
| <p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> | <p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga personeli akademik i lëndës në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Në sekretarinë mësimore GVJ konstatoi këtë në procesverbalet e paraqitura.</p> <p>Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK</p> |
| <p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me takime me studentët, ku jepen komente dhe këshilla mbi procesin e të nxëniet, për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Staf i akademik mund të kryejë seanca sqaruese, pasi rezultatet të jenë bërë publike nga njësia e sekretarisë mësimore. Në përfundim të korigjimeve pedagogët shpallin edhe testin e zgjidhur, për të rritur transparencën e vlerësimit të tyre.</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p> | <p>GVJ konstatoi që njësitë përgjegjëse kanë treguar seriozitet për plagjiaturën, kopjimin, etj. Sipas RVB dhe rregullores së KPT, Neni 50 [cit]: <i>kopjimi nga materiale të shkruara ose nga fleta e provimit të studentëve të tjerë, si edhe çdo komunikim me të tjerët gjatë orës së provimit dënohet me ndërprerjen e provimit për studentin që shkel rregullin, dhe studenti vlerësohet me notën 4 (katër) në lëndën në fjalë.</i></p> <p><i>Plagjiatura e provuar në paraqitjen e detyrës së kursit, punës së laboratorit dhe të diplomës ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare në disiplinën ose veprimtarinë formuese përkatëse, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese.</i></p> <p><i>Në rast përsëritjeje të plagjiaturës ose të kopjimit, emri i studentit shënohet në regjistrin e Këshillit të Etikës dhe studenti paralajmërohet për përjashtim nga Institucioni. Herën e tretë të përsëritjes së kopjimit ose të plagjiaturës studenti përjashtohet nga Institucioni dhe humbet çdo të drejtë financiare që mund t'i takojë në bazë të kontratës së lidhur me KPT.</i></p> <p>Ref: Evidenca 4 Rregullorja KPT, neni 50</p> |



| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> | <p>Siç citohet edhe në RVB e Rregulloren e programit të studimit TAK, dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Vlerësimi për komponentët e tjerë të vlerësimit dorëzohet përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe siç u shkrua edhe më lart nëse nuk janë plotësuar të gjitha detyrimet vjetore studenti nuk lejohet të hyjë në provimin përfundimtar. Për studentin, që nuk merr pjesë në provimin përfundimtar të lëndës, Sekretaria Mësimore në procesverbalin përfundimtar të lëndës bën shënimin “Nuk u paraqit”.</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit TAK</p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> | <p>GVJ konstaton se KPT dhe DESMA, garantojnë të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin e pedagogut, mund të kërkojnë rishikimin e vlerësimit, në përputhje me rregulloren.</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit parashikohet e drejta e ankimit / apelit të studentit. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (testim apo kolokium, detyrë kursi/detyra praktike/punë laborator, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t’i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Më pas, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit TAK</p> |
| <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p> | <p>Referuar RVB për çdo kërkesë/ankimim ndiqet kjo procedurë: Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Rektori, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, ku bën pjesë dhe pedagogu i lëndës, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është <i>përfundimtar</i> dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit TAK</p> |
| <p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Vlerësimi i vazhdueshëm bëhet në këto forma: me teste, pyetje-përgjigje me gojë në ushtrime, detyrë kursi dhe provim përfundimtar. Pësha që mban secili prej formave është:</i> <ul style="list-style-type: none"> ○ Aktivizimi në ushtrime 10 pikë ○ Kolokiume/detyra kursi/laboratorë/praktika 30 pikë | |





- *Provimi përfundimtar i lëndës* 60 pikë
- *KPT/DESMA dhe pedagogët përkatës synojnë të sigurojnë që:*
 - *Vlerësimi i studentëve të jetë i drejtë dhe transparent për provimet apo çdo formë mësimdhënie.*
 - *Vlerësimi të bazohet në meritën e çdo studenti, duke luftuar vjedhjen, plagjaturën, kopjimin.*
 - *Çdo student të ketë të drejtë edhe procesin e ankimimit, sipas një procedure të përcaktuar dhe të njohur më herët prej tyre. GVJ konstatoi se për çdo kërkesë/ankimim ndiqet procedurë.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi III.4
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> | <p>Mbështetur në dosjen e vetëvlerësimit, në takimin me studentët GVJ kostaton se kurrikula e programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” realizon marrjen e njohurive teorike në lëndët përkatëse dhe zhvillimin e aftësive profesionale të veçanta:</p> <ul style="list-style-type: none"> - në përzgjedhjen instalimin, vënie në punë, riparimin, shërbimin, mirëmbajtjen e sistemeve HVAC, për sektorin e banesave dhe ndërtesave komerciale; - në të lexuarit/kuptuarit e projekteve të sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar dhe ftohjes (HVAC-R) të ndërtesave, duke llogaritur rrjetin me ndihmën e kompjuterit, etj. <p>GVJ mendon se këto aftësi janë kombinim i njohurive të thelluara teorike, punëve laboratorike dhe praktikës profesionale.</p> <p>Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK Ref: Evidenca 46 Broshura KPT Ref: Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR.pdf</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p> | <p>Në kuadër të formimit të profesionistit që duhet të ketë aftësi jo vetëm në fushën e Teknologjisë së Ajrimit dhe Kondicionimit, por edhe në fushat sociale dhe të komunikimit, GVJ analizoi lëndët dhe syllabuset e tyre. GVJ konstatoi se kurrikula e programit të studimit dhe veçanërisht lëndët: Anglisht dhe</p> |



| | |
|--|---|
| | <p>Moduli Jean Monet, dixhitalizimi në sektorin publik/privat synojnë të garantojnë njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK Ref: Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR.pdf</p> |
| <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p> | <p>Nga takimet me stafin dhe studentët, GVJ konstatoi se pedagogët përpara përfundimit të lëndës bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Çdo pedagog thekson çështjet më të rëndësishme të lëndës dhe ku duhet të përqendrohen me shumë dhe i orienton studentët për detyrimet përmbyllëse (provim, etj).</p> <p>Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK</p> |
| <p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p> | <p>Mësimdhënia realizohet nëpërmjet orëve teorike si dhe orëve praktike, në laboratorët dhe ofiçinat të ngritura posaçërisht në ambientet e KPT për programin e studimit "Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi". Laboratorët janë një pikë e fortë e këtij institucioni. Organizimi i punëve laboratorike bëhet në grupe 10-12 studentë, ku postet e punës janë të dedikuara për çdo student.</p> <p>Realizimi i praktikave profesionale të studentëve të vitit të dytë garantohet nga marrëveshjet bashkëpunuese që KPT, ka nënshkruar me punëdhënësit e aktorët e biznesit. Praktikrat profesionale të zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në formatin përkatës, që shoqërohet me vlerësim. Kolegji Profesional i Tiranës synon për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve. KPT bashkëpunon me disa IAL në Shqipëri si UET, UPT, UAMD dhe CIT, në fushat akademike me interes të përbashkët (shkëmbim stafi akademik, personel administrativ, shkëmbim studentësh, shkëmbim të materialeve akademike, etj). KPT ka marrëveshje edhe bashkëpunime në nivel rajonal në Europë, si dhe është pjesë e projekteve europiane⁶.</p> <p>Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se studentët falë</p> |

⁶ KPT në bashkëpunim me Njësinë Kombëtare të Ozonit organizuan forumin interaktiv të zgjeruar me anëtarë të stafeve dhe me grupe interesi: "Integration of UNEP University Course for into existing Curricula of the Professional College of Tirana". UNEP dhe Agjensitë e tjera të Kombeve të Bashkuara që operojnë nën Protokollin e Montrealit mbi Substancat që Dëmtojnë Shtresën e Ozonit, ofrojnë programe trainimi të shumta për teknikët e sektorit të ftohjes dhe ajrit të kondicionuar. UNEP ofron mundësi për të ndihmuar edukimin e studentëve me njohuritë dhe aftësitë e duhura për të menaxhuar sa më mirë refrigjerantët, si dhe për të kuptuar aspektet teknike dhe politikat e sektorit të ftohjes dhe ajrit të kondicionuar në kushtet globale të mbrojtjes së shtresës së ozonit dhe ndryshimeve klimaterike.

| | | | | |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| | <p>projekteve ju është bërë e mundur zhvillimi i praktikave në skema mobiliteti, job shadow, etj.</p> <p>Ref: Evidenca 22 Laboratorët Ref: E 33 Lista e partnerëve marrëveshjeve të bashkëpunimit Ref: Evidenca 38 Praktika Connected through Mobility Ref: Evidence 10 Lista e marrëveshjeve IAL-Marreveshjet, Ref: Evidence 10.2 MoU_Uth Ref: Evidence 11.3 USIA roundtable/ USIA/</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p> | <p>Në RVB deklarohet se <i>personeli akademik, efektiv dhe me kontratë zhvillon leksione, orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të teknologjisë dhe shkencës dhe për t'ju shërbyer studentëve me shembuj të praktikave të suksesshme.</i> Veprimtaritë dhe trajnimet ekstra kurrikulare për studentët janë pjesë përbërëse integrale e portofolit të KPT. KPT prezanton risitë në fushat e ndryshme të industrisë apo teknologjisë, duke organizuar takime të ndryshme në mjedise teknologjike siç mund të jenë: vizita në kompani, sektorë industrialë apo biznese lokale. Çdo vit bëhet trajnimi i certifikuar i studentëve të “Teknologjisë së Ajrimit dhe Kondicionimit” dhe “Elektro Mekanikës” në bashkëpunim me Njësia Kombëtare e Ozonit për risitë e fushës si “Teknologjitë e reja ne Sistemet e ftohjes dhe Kondicionimit”, “Sistemet e ftohjes dhe impakti i tyre në mjedis”, “Amendamenti Kigalit dhe alternativat e zëvendësimit të HCFC dhe HFC”, etj, duke qenë një vlerë e shtuar për studentët.</p> <p>Ref: Evidenca 49 Prezantimet në Departament Ref: Evidenca 31 Takime me biznese</p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>GVJ vlerëson se programi i studimit profesional “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” synon të rrisë aftësitë krijuese dhe zbatuese tek studentët. Veprimtaritë mësimore në praktikat profesionale synojnë zhvillimin e kompetencave profesionale.</i> - <i>Realizimi i praktikave profesionale garantohej nga laboratorët e ofiçinat e KPT si edhe marrëveshjet bashkëpunuese që KPT, ka nënshkruar me punëdhënësit e aktorët e biznesit.</i> - <i>Veprimtaritë dhe trajnimet ekstra kurrikulare për studentët janë pjesë përbërëse integrale e portofolit të KPT. KPT prezanton risitë në fushat e ndryshme të industrisë apo teknologjisë.</i> - <i>Në këtë program studimi janë shumë të rëndësishme aktivitete ekstrakurrikulare në mbrojtje të mjedisit (psh ato me Njësine Kombëtare të Ozonit)</i> | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |



Standardi III.5**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike. | GVJ evidenton se në Rregulloren e KPT dhe të programit të studimit të cilat janë publike, specifikohen qartë detyrimet përmbyllëse që ka studenti. Nga takimi me drejtuesit dhe studentët e programit u deklaruar se me detyrime t përmbyllëse studentët njihen paraprakisht nëpërmjet email-eve. Detyrimet për çdo lëndë jepen në çdo syllabus, në mënyrë që studentit të përgatisë materialet që duhet të dorëzojë, si punime të punëve të laboratorëve, detyra kursi, mbrojtja e praktikës profesionale. Sipas një vendimi të Rektorit detyrimi përmbyllës mund të jetë një provim i përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtja e një punimi Diplome (për studentët me mesatare mbi 8). Në rregullore ka disa nene për procedurat e sekretimit, vlerësimin, ankimimit apo përsëritjes së provimit përmbyllës. Gjithashtu jepen procedurat e mbrojtjes së temës së diplomës (nëse ka raste të tilla). Ref: Evidenca 4 Rregullorja KPT, kreu IX Ref: Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit TAK.pdf Ref: Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale.pdf Ref: Evidenca 5.5 SYLLABUS.pdf |
| Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Nga takimi me stafin dhe drejtuesit u konstatua se Stafit akademik në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore organizojnë konsultime para provimeve, takime sqaruese me studentët informacione që lidhen me dorëzimin e punëve laboratorike dhe instruksione për dorëzimin e dosjes së praktikës profesionale. Kjo procedurë bëhet duke përcaktuar oraret. Ndërkohë, procesi i praktikave profesionale ndiqet nga Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentit në bashkë-punim me departamentin. Strukturat përkatëse të cituara më lart, asistojnë studentët, edhe në funksion të provimit përfundimtar të diplomimit. Ref: Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit TAK.pdf Ref: Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale.pdf |
| Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës | GVJ konstaton se, gjatë përgatitjes së procesit të zhvillimit të provimit përfundimtar, Departamenti DESMA, bazuar në rregulloren e programit të studimit TAK, evidenton kategoritë e lëndëve themeltare që duhet të përmbajë provimi përfundimtar. Në bashkëpunim me stafin akademik, përgjegjës për mbulimin e këtyre lëndëve, hartojnë dhe miratojnë përmbajtjen e pyetjeve të |



| | |
|---|--|
| specifike. | <p>testit. Provimi përfundimtar është i ndërtuar nga pesë kategori pyetjesh për gjashtë lëndë që janë më përcaktuese për profesionin e studentëve. Pësha e secilës lëndë në provimin përfundimtar përcaktohet me përqindje dhe total pikësh të përcaktuara për çdo grup pyetjesh.</p> <p>Ref: Evidenca 50 Programi dhe Model teze PPP Ref: Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit TAK.pdf</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> | <p>GVJ konstaton në planin mësimor të programit të studimit TAK, si detyrim përmbyllës temë diplomimi /provim përmbyllës, me 7 ECTS. Në planin mësimor janë deklaruar 12 orë në auditor (për konsultime, etj). Për vitin akademik 2022-2023, për studentët me notë mesate mbi 8, u dha mundësia e mbrojtjes së punimit (temë) diplome. Deri tani asnjë student i programit të studimit TAK nuk ka preferuar të mbrojë temë diplome si detyrim përfundimtar.</p> <p>Ref: Evidenca 5.3 Plani mësimor TAK; Evidence 4 Rregullorja KPT, kreu IX</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p> | <p>Nuk ka patur tema diplome të mbrojtura nga studentët, për vitin 2022-2023. Drejtuesi i njësisë bazë përcakton pedagogët, të cilët do të ndjekin studentët në zhvillimin e praktikës. Institucioni pritës ofron një profesionist për mbikqyrjen në realizimin e praktikave profesionale nga studentët. Pedagogu mbikëqyrës mban kontakte të vazhdueshme me mbikëqyrësin në subjektin pritës, i cili përgatit një vlerësim për çdo student, në fund të praktikës. Pedagogu mbikëqyrës është përgjegjës për monitorimin e mbarëvajtjes së studentit në praktikë dhe i ndihmon në përgatitjen dhe dorëzimin e materialeve përkatëse. Pedagogu mbikëqyrës bën një vlerësim paraprak nëse puna e dokumentuar nga studenti është e përshtatshme për t'u dorëzuar para komisionit, apo nëse duhet të rishqyrtohet.</p> <p>Ref: Evidence 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale, Ref: Evidence 5.2 Raporti i praktikave</p> |
| <p>Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.</p> | <p>GVJ konstaton se Rregullorja e KPT ka të përcaktuar qartë mënyrën, modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijës. Provimi përfundimtar ose/dhe Tema e diplomës vlerësohen me notë. Siç është shkruar më lart ka një korelacion midis pikëve të fituara në test dhe notës përkatëse. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal.</p> <p>Ref: E. 4 Rregullorja e KPT, KREU V, Kontrolli dhe Vlerësimi i Dijës</p> |
| <p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me "Çertifikatë profesionale" ose</p> | <p>GVJ nga DVV evidenton se Programi profesional i studimit jouniversitar TAK, realizohet me 120 kredite. Kohëzgjatja</p> |

CEVY shka



| | |
|---|--|
| <p>“Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> | <p>normale është 2 vite akademike (4 semestra) dhe në përfundim të tij lëshohet “Diplomë Profesionale” në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”.</p> <p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion Diploma. Forma e diplomës është aprovuar nga QSHA me Urdhërin nr. 434, datë 17.12.2020. Pas përfundimit të studimeve, studenti ka të drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të kurrikulës (Lista e notave, planit mësimor, syllabuseve) të programit të studimit të zhvilluar. Në RVB thuhet: Për diplomat profesionale 2 vjeçare nuk parashikohet lëshimi i suplementit të diplomës.</p> <p>GVJ konsultoi Vendimin i KM nr.185, datë 25.3.2021, “Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar dhe në të nuk përmendet (por nuk përjashtohet) lëshimi i detyruar i suplementit dhe pajisjen e studentit me këtë dokument shumë të rëndësishëm akademik (sidomos për ‘transparencën’ ndërkombëtare).</p> <p><i>Prandaj GVJ mendon se lëshimi i suplementit të diplomës (në dy gjuhë) duhet si një shoqërues i domosdoshëm i diplomës profesionale, sidomos kur diploma kalon në procedurën e njohjes në një institucion njohje/ekuivalentimi (NARIC) jashtë Shqipërisë. Ka IAL në Shqipëri që e lëshon këtë dokument. Studentët pajisen përkatësisht me numër matrikulli nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. (sipas ligjit 80/2015, neni 91)</i></p> <p>Ref: Evidenca 1 VKM numër 699, datë 26.08.2015 Ref: Evidenca 40 Miratimi i Diplomës, Modeli i Diplomës.pdf Ref: Vendim i KM nr.185, datë 25.3.2021, “Për ndryshime</p> |
| <p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p> | <p>GVJ konstatoi se: KPT mbledh, ruan dhe përpunon të dhënat personale të studentëve në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna regjistrohen dhe ruhen në regjistrat përkatës dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të KPT.</p> <p>Në lidhje me ecurinë e studentëve KPT zbaton legjislacionin duke hedhur të dhënat në Regjistrin Themeltar, Regjistrin e arritjeve akademike dhe Regjistrin e Diplomave. KPT ruan për një periudhë të pacaktuar (përgjithmonë) kopje të dokumentacionit të studentit. KPT disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.</p> |
| | |

(Signature)

(Signature)

| | |
|--|---|
| | Ref: Evidenca Statuti i KPT, Neni 48 – Ref: Evidenca 45 Regjistri baze themeltar.pdf Ref: Evidenca 45.1 Regjistri i arritjeve akademike.pdf Ref: Evidenca 45.2 Regjistri i diplomave.pdf |
|--|---|

Konkluzione

- *GVJ konstaton se KPT ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.*
- *Në rregullore janë të përcaktuara të gjitha hapat për provimin përfundimtar, që nga lëndët që përfshihen, hartimi i tezave, korigjimi i provimeve, procedura e ankimimit, etj.*
- *Në përfundim të studimeve studenti pajisjet me “Diplomë Profesionale” në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”. dhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit i vihet në dispozicion.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | <p>GVJ konstaton se stafi akademik dhe drejtuesit janë të interesuar për metoda inovative në mësimdhënie, sidomos për ato ku zbatimi në praktikë është pjesë përbërëse. Referuar RVB, nëse metoda miratohet si inovative, bëhet edhe trajnimi i personelit akademik për të përvetësuar këto metodologji në funksion të mësimdhënies. Psh kjo gjë u bë e evidente gjatë periudhës së Pandemisë së Covid-19, kur mësimi u zhvillua online. Për të ndihmuar stafin akademik u hartua Udhëzuesi “Mësimi online”, i cili u publikua edhe në faqen e internetit të KPT.</p> <p>Ref: https://kolegjiprofesional.edu.al/meso-online/</p> |
| Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | <p>Nga RVB dhe takimi me drejtues, GVJ konstatoi se KPT operon në disa nivele të shqyrtimit dhe monitorimit të personelit të tij për të garantuar cilësi dhe profesionalizëm në këtë proces. Vlerësimi i aftësive të personelit kryhet:</p> <p>a) Nga eprori direkt, ku pedagogu i nënshtrohet vlerësimit nga eprori në formën e kontrolleve të herë pas herëshme gjatë procesit mësimor si dhe vëzhgimit të punës mësimore në përshtatshmëri me syllabuset (Evidence 13.2 Raporti</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>NJBSC);</p> <p>b) nga studentët, kryesisht me anë të pyetësorëve, duke garantuar anonimitetin e tyre;</p> <p>c) nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe e Kontratave që mban dosjet e personelit dhe mundëson trajnime të ndryshme për stafin,</p> <p>d) zyra e NjBSC, e cila ka zhvilluar një pyetësor për të marrë informacion për qëndrimin dhe qasjen e stafit në lidhje me disa elementë të caktuar të procesit akademik.</p> <p>Ref: Evidenca 3 Statuti Ref: Evidenca 29 Manuali i Burimeve Njerëzore Ref: Evidenca 13.2 Raporti NjSBC Ref: Evidenca 15 Formularet e vlerësimit studente Ref: Evidenca 16 Fokus Grupe Ref: Evidenca 6.4 Anketa e Stafit</p> |
| <p>Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> | <p>Sipas RVB e takimet e zhvilluara, GVJ konstatoi se NjBSC, si strukturë përgjegjëse, informon drejtuesit e Departamenteve. Këto informojnë stafet e tyre, rreth rezultateve të kontrolleve të zhvilluara. GVJ konstatoi se ky informim bëhet në raportin vjetor, me synim marrjen e masave për përmirësimin e performancës së tyre dhe të njëjësive të tij bazë.</p> <p>Ref: Evidenca 13.1 Rregullore NjSBC Ref: Evidenca 13.2 Raporti NjSBC</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> | <p>GVJ evidenton mbi bazën e DVV dhe vizitës në KPT se Kolegji Profesional i Tiranës ndihmon stafin akademik në rritjen e mëtejshme profesionale dhe synon inkurajimin e tyre për të ndjekur seminare apo forume të ndryshme, që i aftësojnë ata në metoda të mësimdhënies si dhe formimit të tyre akademik.</p> <p>Për faktin se Institucioni ofron vetëm programe 2-vjeçare me karakter profesional, fokusi i stafit është në kërkimin e aplikuar. Puna kërkimore e personelit akademik përcaktohet nga Departamenti në kuadër të akteve rregullatore të KPT. Në dokumentin e paraqitur gjenden të dhëna të plota për veprimtarinë kërkimore të stafit. KPT nxit organizimin e orëve të hapura si një formë e shpërndarjes së përvojës në mësimdhënie, mbështet botimet e artikujve shkencorë apo projektet ku stafi akademik është përfshirë.</p> <p>Ref: Evidenca 31 Prezantimet në Departament Ref: Evidenca 48 Artikuj Botime Promo Libri Ref: Evidenca 6.2 Veprimtari të Stafit në projekte, trajnime Ref: Evidenca 19 Politika e kërkimit të aplikuar në KPT Ref: Evidenca 19/1 Kërkimi i aplikuar</p> |




Konkluzione

- *GVJ konstaton se KPT ndjek një politikë që promovon cilësinë në mësimdhënie.*
- *Vlerësimi i aftësive të personelit lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor kryhet: a) nga eprori direkt, b) nga studentët, c) nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe nga d) zyra e NjBSC.*
- *Institucioni ka ndërmarrë zhvillimin e një ankete, me anë të një pyetësi, me qëllim për të marrë informacion, qëndrimin dhe qasjen e stafit.*
- *Informimi për vlerësimin bëhet në raportin vjetor, me synim marrjen e masave për përmirësimin e performancës së stafit dhe të njësive të tij bazë.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|--|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|-----|-----------|-----|-----------|-----|---|-----------|--|-----------|--|-----------|--|-----|-----|-----|-----|-----|-----|--|--|--|--|--|--|--|
| Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | <p>GVJ nëpërmjet dokumentave, tabelave dhe takimeve, konstaton se personeli i KPT përbëhet nga personeli akademik, ndihmës mësimor (mungon ai ndihmës akademik) dhe personeli administrativ Personeli i KPT mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme (Evidence 3 – Statuti, neni 37). Kontrata e punës bazohet në legjislacionin në fuqi dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve (Evidence 29/2 Kontrata e tip e punë).</p> <p>Sipas Tabelës 6.1 të dhënat për stafin që ka mbuluar programin e studimit në 3 vitet e fundit janë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Stafi akademik për programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | | | | | | Stafi akademik për programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” | 2020-2021 | | 2021-2022 | | 2022-2023 | | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK | | | | | | | |
| Stafi akademik për programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” | 2020-2021 | | 2021-2022 | | 2022-2023 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|--|----------|----------|-----------|----------|----------|----------|
| | Prof. Dr | 2 | - | 2 | - | 2 | - |
| | Prof. As | - | - | - | 1 | - | - |
| | Dr | - | - | - | - | - | 1 |
| | Msc. | 6 | 1 | 8 | - | 6 | 5 |
| | MND | - | - | - | - | - | 1 |
| | Bsc | - | - | - | 1 | - | - |
| | Totali | 8 | 1 | 10 | 2 | 8 | 7 |
| | <p>GVJ konstaton se të gjithë anëtarët e personelit akademik kanë të paktën kualifikimin minimal që nevojitet për mbulimin e lëndëve/moduleve të programit profesional të studimit 2 vjeçar në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” (sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës). Ato kanë edhe eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> <p>Nga analiza që GVJ i bëri ngarkesës mësimore të PAE dhe PAK rezulton se PAE realizon 761 orë mësimore në auditor dhe PAK realizon 302 orë, pra 72% / 28%.</p> <p>Ref: Evidence Tabela 6, TA TAK.pdf Ref: Evidence 29 Manuali i Burimeve Njerëzore</p> | | | | | | |
| Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | <p>GVJ evidenton se sipas Evidencës 29/3 - Vendimi i Rektoratit për përcaktimin e ngarkesës mësimore për stafin efektiv ngarkesa është 360 orë⁷. Nga analiza e tabelës përkatëse rezulton se stafi akademik është me ngarkesë brenda udhëzimit të Rektorit.</p> <p><i>GVJ nuk ka evidencë për numrin e lëndëve në semestër që zhvillon personeli akademik. Sipas Udhëzimeve të sipërcituara i lejohen deri në 3 tre lëndë semestrale.</i></p> <p><i>Nga Tabelat 12 konstatojmë se disa pedagogë zhvillojnë 5-7 lëndë (në të dy programet e studimit që analizon ky Grup i jashtëm i vlerësimit). Ndërkohë në këtë numër lëndësh nuk është llogaritur lënda e praktikës profesionale, që këto pedagogë kanë si lëndë shtesë në ndjekjen e studentëve.</i></p> <p>Evidence 29/1 Dosja e Personelit Ref: Evidence Tabela, TA TAK.pdf</p> | | | | | | |
| Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit | <p>GVJ konstaton se në periudhën 2017-2023 (gjatë periudhës midis dy akreditimeve) KPT dhe DEMSA kanë treguar</p> | | | | | | |

⁷ Sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL, pika II. 1, i ndryshuar me Udhëzim nr. 36, datë 23.11.2018 e Udhëzim nr. 37, datë 04.12.2018) ngarkesa për asistent-lektorë me Msc. është 195 orë, por ai mund të realizojë edhe 200 orë suplementare në auditor. Për autoritetet drejtuese Rektor është 50 orë, Përgjegjës departamenti është 90 orë.

Erly shleg

[Signature]

| | |
|--|--|
| <p>akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p> | <p>qëndrueshmëri të personelit akademik. Në 3 vitet e fundit personeli akademik është i njëjtë. Pra, Institucioni garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Institucioni e konsideron qëndrueshmërinë e stafit si një faktor kyç të suksesit për shkak të [cit]:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) <i>Cilësia në përzgjedhje dhe përputhja e eksperiencës me lëndët;</i> 2) <i>Respektimi i dyanshëm i kontratës. KPT respekton dhe përmbush kërkesat dhe detyrimet kontraktuale (financiare, sigurimet shoqërore dhe kodin e punës) për personelin;</i> 3) <i>Institucioni siguron raporte midis kategorive të personelit akademik, moshës, eksperiencës, etj. dhe shkëmbimin e eksperiencës midis brezave.</i> <p>Ref: Evidenca 3 – Statuti, neni 37 Ref: Evidenca 29/2 Kontrata e tip e punës</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Nga dokumentacioni i bashkëngjitur dhe nga takimi në Zyrën e BNj dhe Kontratave, GVJ konstaton se KPT ka përcaktuar politika të qarta të rekrutimit të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, referuar dhe Statutit dhe Ligjit të AL. GVJ konstaton se stafi përzgjidhet me procedurë selektimi dhe intervistimi (sipas Manualit të Burimeve Njerëzore). Propozimet për staf të ri burojnë nga Departamenti, i cili propozon profilin akademik dhe profesional të kandidatit. Aproximin final e bën Rektori. Rekrutimi i personelit akademik i nënshtrohet praktikave të përcaktuara përkundrejt aplikimit me dosje (të cilat ruhen në një “pool database”) dhe intervistës së personalizuar me të interesuarit.</p> <p>Përzgjedhja bëhet me seleksionim paraprak (screening që realizohet nga Zyra e BNj dhe e Kontratave dhe intervistës si dhe duke zhvilluar orë të hapura leksioni në praninë e komisionit të rekrutimit. Kriteret përcaktohen nga DEMSA, mbështetur në nevojat që paraqiten për realizimin e procesit mësimor dhe miratohen nga Rektori. Kandidatët vlerësohen dhe përzgjidhen sipas meritave nga Komisioni i Rekrutimit (për personelin akademik si rregull përbëhet nga: Administratori, Rektori, Drejtuesi i Zyrës së Burimeve Njerëzore, Përgjegjësi i Departamentit përkatës dhe sipas rastit pedagogë nëse gjykohet e nevojshme).</p> <p>Ref: Evidenca 3 – Statuti, neni 39 Ref: E 29 Manuali i Burimeve Njerëzore / Procesi i rekrutimit</p> |

(Signature)

(Signature)

| | |
|---|--|
| | Ref: Evidenca 29/1 Dosja e Personelit |
| <p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> | <p>Sipas RVB, tabelave të përmbledhura dhe takimeve në institucion rezulton se DEMSA nuk ka personel ndihmës akademik GVJ konstaton se personeli akademik/administrativ përzgjidhet me konkurs dhe vlerësimi bëhet në bazë të përmbushjes së kriterëve të shpallura dhe ekspertizës profesionale. Nisur nga natyra e KPT dhe programeve që ai ofron, një rëndësi të veçantë në procesin e rekrutimit i jepet atyre kandidatëve të cilët kanë një përvojë të gjatë e të suksesshme në profesion dhe janë unikë në fushën e tyre të specializimit.</p> <p>Ref: E 29 Manuali i Burimeve Njerëzore / Procesi i rekrutimit</p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p> | <p>GVJ konstatoi në evidencat në DVV, si dhe në vizitat në institucion se KPT mbledhin/ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë të gjithë anëtarët e personelit akademik të programit të studimit, të personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit në lidhje me personelin akademik me kohë të plote dhe të pjesshëm. Përveç angazhimit në mësimdhënie në auditor, personeli akademik ka për detyrë të zhvillojë orë për tutoriat si dhe të mbikqyrë studentët gjatë zhvillimit të praktikës mësimore. Në fund të çdo semestri paraqitet ngarkesa e realizuar për çdo anëtar stafi.</p> <p>Ref. Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit, neni 3 (6) Ref. Evidence 29 Manuali i Burimeve Njerezore, Ref. Evidence 29/1 Dosja e personelit.</p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> | <p>GVJ evidenton se Institucioni ka garantuar që përveç laboratoreve të programit të studimit në dispozicion për procesin akademik, për pjesën e praktikës profesionale të vitit të dytë të sigurojë marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale me kompani e biznese private. Nga Tabela e bashkëpunimeve rezultojnë këto të dhëna: 124 Marrëveshje në kuadër të institucionit dhe 22 Marrëveshje në kuadër të vetë programit TAK.</p> <p>KPT/DEMSA, në marrëveshje dhe bashkëpunim me biznese e kompani, vë në dispozicion personelin e kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Personeli ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me personin mbikqyrës të studentit të caktuar nga subjekti pritës.</p> |




| | |
|--|--|
| | <p>Ref: E 33 Lista e partnerëve/marrëveshjeve të bashkëpunimit; Ref: Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikës profesionale</p> |
| <p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p> | <p>Nga DVV, GVJ konstaton se subjekti pritës cakton një person mbikëqyrës për çdo student që kryen praktikën. Ky person është pikë kontakti me KPT dhe në përfundim të zhvillimit të praktikës plotëson një formular vlerësimi për studentin praktikant. Në fund të praktikës profesionale studenti përgatit një raport përfundimtar për punën e kryer dhe përvojë në subjektin pritës. Elementët përbërës të dosjes së vlerësimit të studentit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Raporti përfundimtar i studentit; Vlerësimi i pedagogut që ndjek zhvillimin e praktikës nga student; Vlerësimi i personit mbikqyrës të caktuar nga institucioni /subjekti pritës. <p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritës, e ndihmon studentin në përmbushjen e detyrimeve/ raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tij/tyre për praktikën profesionale.</p> <p>Ref: Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikës profesionale, Neni 4 Ref: Evidenca 5.4 Dosja e praktikës</p> |
| <p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> <i>GVJ vlerëson që personeli akademik që mbulon programin e studimit profesional “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, përmbush standardet për kualifikimin e duhur dhe të posaçëm akademik e profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i> <i>Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës-akademik, personelit administrativ në KPT bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë.</i> <i>GVJ konstatoi se KPT mbledhin/ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit.</i> <i>Institucioni ka garantuar marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale me kompani e biznese private. Nga Tabela e bashkëpunimeve rezultojnë 124 Marrëveshje në kuadër të institucionit dhe 22 Marrëveshje në kuadër të vetë programit TAK.</i> <i>Personeli në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve dhe marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</i> <i>Disa pedagogë zhvillojnë 5-7 lëndë (në të dy programet e studimit që analizon ky Grup i jashtëm i vlerësimit). Ndërkohë në këtë numër lëndësh nuk është llogaritur lënda e praktikës profesionale, që këto pedagogë kanë si lëndë shtesë në ndjekjen e studentëve.</i> | |




| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X | |

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> | <p>GVJ konstaton se Kolegji Profesional i Tiranës dhe programi i studimit 2-vjeçar “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme, për zhvillimin e mësimdhënies teorike dhe praktike/laboratorike. Nga vizita në këtë institucion dhe dokumentacioni në DVV, rezulton se: mjediset e KPT në funksion të mësimdhënies janë: 3 auditorë/klasa leksionesh, 4 klasa seminaresh 6 laboratorë + 2 laboratorë informatike, 1 sallë interneti, 1 bibliotekë, 1 mjedis shlodhës/kafeteri, 16 nyje hidrosanitare, mjedise për stafin zyra, sallë mbledhjesh, etj. Në Tabelën e infrastrukturës deklarohen disa ambiente të përbashkëta me UET (për të cilat ka edhe marrëveshje dypalëshe). Kapaciteti normativ deklarohet 5.8 m²/për student, (sipas udhëzimeve normativa minimale është 5.0 m²/për student). Gjithashtu deklarohen edhe 9 zyra për administratën dhe stafin, 5 nyje hidrosanitare ku rezulton normativa 7.8 m²/për punonjës.</p> <p>Nga pikëpamja funksionale GVJ konstaton se hapësirat akademike plotësojnë kushtet në aspektin e lartësisë (çdo kat është 4 metra i lartë), ndriçimit dhe ajrosjes, izolim të sigurt nga zhurmat, shkallë emergjence, etj. Godinat e Kolegjit Profesional të Tiranës janë të vendosura brenda kompleksit të ndërtesave, të quajtur “Kompleksi Xhura”. Të gjitha objektet janë të pajisura me mjete mbrojtjes kundër zjarrit. Fikset e zjarrit janë të vendosur në vende të dukshme dhe lehtësisht të arritshme në rast emergjence zjarri. Mësimi organizohet në grupe mësimore në përputhje me parashikimet ligjore për këtë natyrë programi studimi: grupe deri në 25 studentë në ushtrime, grupe me 10 -12 studentë në laboratore.</p> <p>Ref: Evidenca 34 Infrastruktura Ref: Evidence 22 Laboratorë Ref: Evidence Tabelat 1-24 TAK tabela 16 Infrastruktura Ref: Evidence 10 Lista e marrëveshjeve IAL-Marreveshjet .pdf</p> |
| <p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si</p> | <p>GVJ vizitoi kabinetet dhe auditorët, ku zhvillojnë mësim</p> |

| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>studentët e programit të studimit dhe konstatoi se sallat mësimore janë pajisur me mjete audio vizive si Smart Board, PC, projektorë dhe foni, duke mundësuar përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies për studentët. Laboratorët janë ndërtuar në shërbim të këtij programi studimi dhe i kanë të gjithë pajisjet, aparaturat për zhvillimin e mësimdhënies në lëndët përkatëse. Të gjitha ambientet e KPT janë të pajisura me internet dhe të mbuluara me shërbimin Wi-Fi.</p> <p>Ref: Evidenca 22 Laboratorë Evidenca 34/1 Infrastruktura IT</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> | <p>GVJ vizitoi auditorët dhe laboratorët e programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” si dhe laboratorët e tjerë që përdoren nga studentët e këtij programi profesional, dhe konstatoi se për këtë program studimi janë në dispozicion 6 laboratorë + 2 laboratorë informatike. Këto laboratorë dhe ofiçina janë ndërtuar në shërbim të këtij programi studimit dhe i kanë të gjithë pajisjet, aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit.</p> <p>Ref: Evidence 34 - Infrastruktura Ref: Evidence 22 Laboratorët</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p> | <p>GVJ nga vizita në institucion dhe DVV KPT disponon 4 laboratorë informatike, me 25 poste pune secili, të mirëpajisur me kompjutera, 2 rack të lëvizshëm me 15 laptop secili, që përdoren në salla të ndryshme sipas nevojës, një pool prej 10 laptop të financuar në kuadër të projekteve dhe një laborator SMART - sallë multimediale për takime online dhe hibride.</p> <p>Ref: Evidenca 34/1 - Infrastruktura IT</p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> GVJ vlerëson që Kolegji Profesional i Tiranës ka vënë në dispozicion të programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik, të posaçëm për natyrën inxhinierike të HVAC, etj. Aktiviteti mësimor zhvillohet në kabinetet dhe auditorët, të pajisur me mjete audio vizive si Smart Board, PC, projektorë, dhe foni, duke mundësuar përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies për studentët. Mjediset infrastrukturore plotësojnë normativat ligjore. Normativa deklarohet 5.8 m²/student. | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |




Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p> | <p>Literatura bazë dhe ndihmëse (fizike dhe elektronike), e vënë në dispozicion të studentëve është në gjuhën shqipe dhe në anglisht. Kjo literaturë është vendosur në syllabuset përkatëse nga personeli akademik. Literatura e rekomanduar synon marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”.</p> <p>Për arsye të vështirësive të hartimit të teksteve lëndore, një pjesë e konsiderueshme e lëndëve mbulohet nga literatura e përgatitur nga vetë stafi akademik, në formën e cikleve të leksioneve, në përputhje me temat në syllabuset përkatëse. Konstatohen se në literaturën e detyruar 14 lëndë kanë leksione të përgatitura dhe 3 lëndë kanë tekste. Ndërsa në literaturën ndihmëse të gjitha lëndët kanë tekste të rekomanduara me autorë shqiptarë dhe të huaj. Këto materiale janë vënë në dispozicion studentëve në bibliotekën e KPT.</p> <p>Studentët përveç materialeve të printuara në kopje fizike, mund të shfrytëzojnë edhe platformat online si Sharefolder, e cila aksesohet vetëm nga kompjuterat e lidhur në rrjetin e shkollës. Platforma Teams dhe Share point i japin akses studentëve edhe në literaturë sipas lëndëve përkatëse që zhvillojnë. KPT ka krijuar <i>Open Educational Resources</i> (OER) me materiale mësimore dhe kërkimore të cilat janë lëshuar nën një licencë të hapur, që lejon aksesin, përdorimin, ripërdorimi dhe rishpërndarja nga të tjerët pa kufizime ose të kufizuara. Falë marrëveshjes së bashkëpunimit, me UET, KPT ka akses në një portofol edhe më të gjerë titujsh dhe katalogësh. Pjesë e fondit të bibliotekës bëhen dhe botimet dhe publikimet në vite të stafit akademik.</p> <p>Ref: Evidenca 3, Statuti, neni 15, b Ref: Evidenca 5.5 Syllabus.pdf; Ref: Evidence 34/2 Rregullore e Bibliotekes Ref: Evidence 34/3 Karta e Bibliotekës https://kolegijprofesional.edu.al/online-library-oer/</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë</p> | <p>KPT ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, e vendosur në godinën A, duke garantuar mundësinë</p> |

| | |
|---|--|
| <p>e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> | <p>e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit, e cila funksionon mbi bazën e një rregullore.</p> <p>Ref: Evidenca 34/2 Rregullore e Bibliotekës Ref: Evidenca 34/3 Karta e Bibliotekës Evidence 34/4 – Biblioteka online</p> |
| <p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> | <p>Nga dokumentat dhe vizita në institucion rezulton se Biblioteka e KPT është e pasur në numër të konsiderueshëm botimesh të viteve të fundit. Kontigjenti i librave ka ardhur nga blerjet të financuara nga KPT, donacioneve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me palë të treta, etj, si edhe nga projektet të ndryshme. KPT në sajë të marrëveshjes së bashkëpunimit me UET, ka akses në një portofol edhe më të gjerë titujsh dhe katalogësh. Nga DVV dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se qëllimet, objektivat dhe parimet e bibliotekës janë në funksion të programeve të studimit, studentëve, personelit akademik. Të gjitha materialet që rekomandohen në syllabuset e lëndëve janë pjesë e bibliotekës.</p> <p>Evidence 34/4 – Biblioteka online</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p> | <p>KPT ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, https://kolegji.profesional.edu.al/online-library-oer/ Open Educational Resources (OER) me materiale mësimore dhe kërkimore. KPT ofron libraritë e sugjeruara on-line nga biblioteka ku institucioni është abonuar apo që janë me akses të lirë si openlibrary.org, link të mundësuar nga Biblioteka Kombëtare, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivës së Shtetit, etj.</p> |
| <p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p> | <p>Nga vizita në Bibliotekë, GVJ konstatoi që ajo ofron të gjitha kushtet logjistike dhe ergonomike, është e pajisur me kompjutera, softuere dhe me pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin për të gjithë studentët. Biblioteka dhe koleksionet online mund të aksesohen si nga studentët ashtu edhe nga stafi.</p> <p>Ref: Evidenca 34/2 Rregullore e Bibliotekës</p> |
| <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p> | <p>Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Salla me fond të hapur është komode dhe në shërbim të plotë të studentëve, personelit akademik, etj, çdo ditë të javës nga e Hëna-Premte 09:00-20:00 dhe e Shtunë 09:00-17:00, kurse gjatë sezonit të provimeve funksionon me orar të zgjatur.</p> <p>Ref: Evidenca 34/2 Rregullore e Bibliotekës</p> |
| <p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe</p> | <p>Sipas RVB dhe nga takimet me drejtuesit GVJ konstatoi se KPT</p> |

raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.

bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer studentëve dhe pedagogëve. Përgjegjësit e programit të studimit hartojnë plane për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. Në mënyrë sistematike kërkohet nga pedagogët që leksionet, librat apo botime të depozitohen në bibliotekë.

Konkluzione

- *GVJ konstaton se programi i studimit TAK përmban literaturën e nevojshme të detyruar dhe të rekomanduar, të përcaktuar në syllabuset e lëndëve. Literatura është në mbështetje të mësimdhënies.*
- *KPT ka ndërtuar edhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, si bibliotekën, mjedise të posaçme, shlodhëse dhe rekreative.*
- *GVJ konstaton që KPT ndjek një procedure të qartë në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës. Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit dhe funksionon mbi bazën e një rregullore të miratuar.*
- *KPT ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit "Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi". Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit. | Nga vizita në sekretari, GVJ u informua që institucioni ka platformën e sistemit të menaxhimit të informatizuar, nëpërmjet të cilit administrojnë të dhënat / database për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Aplikacionet në nivel institucioni janë të vendosura në Classter, sistemi është mundësuar në bazë të kontratës përkatëse të lidhur me shoqërinë Tech360 shpk http://tech360.al/rrethnesh/ Sistemi Classter mundëson gjenerimin e raporteve të ndryshme |

| | |
|--|---|
| | <p>të kërkuara nga sekretaria mësimore dhe zyra e financës; integrimin me posten elektronike të stafit/studentëve (Microsoft Office365) si dhe me materialet akademike. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga sekretaria mësimore, ku përdorimi i platformës së informatizuar është komplementar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe akteve nën ligjore në fuqi. Stafi /studentët kanë akses të dedikuar, sipas detyrave të tyre (Hedhje notash, materialesh mësimore/lexim notash,etj). Bazuar edhe në Statut, sekretaria e KPT mban në formë të shkruar: <i>Rregjistrin themeltar të studenteve; Rregjistrin e arritjeve akademike; Rregjistrimin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave; dokumentacionet e provimeve (Procesverbalet); regjistrat e klasës, Tabelat përmbledhëse, etj), dosjet e studentëve dhe dokumentet zyrtare, që lidhen me procesin e regjistrimit, transferimit, apo largimit nga shkolla.</i></p> <p>Ref: Evidence 28/1 Sistemi Classter Ref: Evidenca 45 Regjistri bazë themeltar Ref: Evidenca 45.1 Regjistri i arritjeve akademike Ref: Evidenca 45.2 Regjistri i diplomave</p> |
| <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>GVJ nga takimi me personelin e IT konstatoi se sistemi Classter menaxhon informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetet të cilat lidhen me personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ. Ky informacion menaxhohet nga personeli i zyrës së BNJK dhe sekretaria mësimore (sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren përkatëse). Disa nga të dhënat që GVJ i pa gjatë vizitës janë: Kartela e studentit; Portali i pedagogëve, orarin mësimor, dhe sallën përkatëse, etj; Portali i menaxhimit të bibliotekës; portali për menaxhimin financiar (pagesat e studentëve), etj.</p> <p>Ref: Evidence 28 Manuali Classter Ref: Evidenca 28/1 Sistemi Classter Ref: Evidenca 29/1 Dosja e personelit</p> |
| <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Referuar RVB, në sistemin e menaxhimit informatik KPT ka qasje bazuar në përdorues/fjalëkalim (duke zbatuar procedurat e sigurisë së informacionit ISO27001) bazuar në privilegjet dhe hirearkinë e përdoruesit, i ndarë në 3 lloje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Share Folder</i> (nivel lokal) i cili përdoret për të shkëmbyer materiale në rang administrate, stafi akademik, pedagog – student, materiale për studentet, etj. • <i>Share Point</i> (One Drive) pjesë e Office365 ku aksesi mund |

CEVyshly



| | |
|---|---|
| | <p>të lejohet ose jo brenda organizatës, për studentët dhe stafin. Integrimi me platforma të tjera si Forms, Teams, Stream bën të mundur komunikim të sigurt dhe lehtësisht të aksesueshëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> Nëpërmjet sistemit të menaxhimit Classter pedagogu ju mundëson studentëve materiale si literaturën, syllabuse, ushtrime, etj, i cili është i integruar Office365 për të lehtësuar aksesimin e të dhënave. <p>GVJ mendon se KPT ka realizuar një sistem digital menaxhimi që ndihmon procesin mësimor në të gjithë komponentët.</p> <p>Ref: Evidenca 28 Manuali Classter</p> |
| <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> | <p>Sic është shkruar më lart, bazuar në RVB dhe dokumentat në DVV, GVJ konstaton se KPT ka në përdorim platforma dhe module të veçanta që mundësojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Platforma Microsoft Teams dhe Classter ndihmojnë për aksesimin e moduleve, mësim online dhe komunikim të brendshëm elektronik.</p> <p>Portali i Studentit Classter ofron akses në: orarin mësimor për çdo semestër; programet e lëndëve; pikët për çdo lëndë, me gjithë komponentët e vlerësimit; njoftime të ndryshme në lidhje me aktivitetet që zhvillohen.</p> <p>Ref: Evidence 28 Manuali Classter, Ref: Evidence 28/1 Sistemi Classter</p> |
| <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> | <p>Nga takimet në Institucion dhe nga DVV konstatojmë se sistemi i brendshëm i menaxhimit Classter administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, administrativ, studentëve, etj. Ky sistem ndihmon në veprimtarinë e tyre akademike apo administrative dhe lehtëson procedurat. Me anë të sistemit Classter mundësohet raportime individuale me të dhëna në kohë reale për çdo strukturë, organet drejtuese dhe titullarët. Gjithashtu Zyra e Financës përdor sisteme të veçanta që lidhen me kontabilitetin në përputhje me parashikimet ligjore.</p> <p>Ref: Evidenca 28 Manuali Classter Ref: Evidence 28/1 Sistemi Classter</p> |
| <p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p> | <p>Kolegji Profesional i Tiranës ka në funksion faqen zyrtare të internetit https://kolegjiprofesional.edu.al/, në të cilën publikohet informacion mbi programet e studimit, strukturën organizative të institucionit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme në lidhje me jetën akademike, studentore, apo të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë kombëtar e</p> |




| | |
|--|--|
| | <p>ndërkombëtar.</p> <p>Informacioni i faqes zyrtare të internetit azhurnohet në mënyrë të vazhdueshme nga personat përgjegjës në përputhje me Politikën e Mirëmbajtjes së faqes së internetit.</p> <p>Ref: Evidenca 35 Politika e mirëmbajtjes së faqes së internetit</p> |
|--|--|

Konkluzione

- *GVJ konstaton se KPT disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional Classter që menaxhon dhe administron dhe bën monitorimin e aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.*
- *Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga sekretaria mësimore, ku përdorimi i platformës së informatizuar është komplementar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe akteve nën ligjore në fuqi.*
- *Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Stafit /studentët kanë akses të dedikuar, sipas detyrave të tyre (hedhje notash, materialesh mësimore/lexim notash, etj).*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X |

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjese studentëve

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> | <p>GVJ konstaton se KPT zbaton kërkesat ligjore duke raportuar çdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij që përfshin edhe tarifën e shkollimit, administrimin e të ardhura financiare/ bursave/ fondeve kërkimore, etj. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe jo të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.</p> <p>Mbështetur në këtë raport për vitin 2021-2022 të aksesuar në DVV, GVJ evidenton se KPT është IAL private me vetë-financim. Në burimet financiare të KPT përfshihen: tarifën e shkollimit, projekte/grante ndërkombëtare, financimet nga ortakët e shoqërisë “KPT shpk”, në cilësinë e pronarit, të ardhurat nga shërbimet që IAL ofron për të tretë dhe burime të tjera të ligjshme. Të gjitha veprimet në lidhje me kontabilitetin mbahen në programin financiar Alpha i cili gjeneron raportet financiare, për student, për vit, për buxhet, për shpenzime, për të</p> |

Edy Shika

[Signature]

| | |
|---|---|
| | <p>ardhura, etj. Veprimet e shoqërisë kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar duke synuar transparencë të veprimeve financiare. Tarifat janë të publikuara rregullisht në faqen zyrtare të internetit të KPT për çdo vit akademik.</p> <p>https://kolegji_profesional.edu.al/tarifat-e-studimit-dhe-bursat/ Ref: Evidenca 16 Raporti Vjetor</p> |
| <p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> | <p>Sipas RVB, buxheti financiar hartohet në muajin tetor të çdo viti. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Veprimet e shoqërisë kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar duke siguruar transparencë të plotë. Pasqyrat financiare të KPT që përmbajnë: financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura, etj, miratohen nga Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të “KPT shpk” dhe depozitohen elektronikisht në Zyrën e Tatimeve brenda afateve ligjore dhe në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, duke qenë kështu të aksesueshme në çdo kohë nga publiku i gjerë.</p> <p>Ref: Evidenca 16 Raporti Vjetor</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p> | <p>Sic deklarohet edhe në RVB: <i>Mbajtja e llogarive, regjistrimeve dhe veprimeve financiare kryhet në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe duke respektuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Funksionet administrative, ekonomike dhe financiare realizohen nëpërmjet Zyrës së Financës dhe Administratorit të KPT, i cili është një urë komunikimi dhe me Asamblenë e Ortakëve të KPT shpk.</i></p> <p>GVJ konstaton se siç e kërkojnë aktet ligjore pasqyrat financiare auditohen çdo vit nga një palë e tretë e pavarur. KPT është transparent në lidhje me shlyerjen e detyrimeve financiare përkundrejt palëve të treta, si dhe deri tani ka treguar qëndrueshmëri financiare. <i>Pasqyrat financiare japin një pasqyrim në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, në pajtim me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar</p> | <p>Siç deklarohet në RVB, por edhe nga takimet me drejtuesit e IAL, konstatohet se raportet e analizës financiare hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit</p> |




| | |
|--|---|
| të vitit paraardhës. | të lartë. |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p> | <p>KPT deklaron se ka garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe deklaron se është optimist për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p> <p>KPT shqyrton dhe analizon kostot duke kontrolluar ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standarteve. KPT llogarit koston për të gjithë institucionin dhe për programet e veçanta sipas metodologjisë standard, që ka për bazë llogaritjen e shpenzimeve në total/shpenzime të departamentit me numrin total të studenteve/numri i studenteve për departament. Ndonëse aktiviteti i shoqërisë “KPT shpk” është i gjerë, aktualisht i vetmi aktivitet që shoqëria zhvillon është ai i arsimit profesional të lartë në përputhje me licencën e marrë nga organet kompetente.</p> <p>GVJ vlerëson se ky program plotëson ose është afër kuotave të planifikuara të studentëve dhe kjo gjë garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, duke qenë se të ardhurat kryesore vijnë nga tarifat e studimit.</p> <p>Ref: Evidenca 16 Raporti Vjetor</p> |

Konkluzione

- *KPT deklaron se raportet e analizës financiare i harton në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë*
- *GVJ vlerëson se KPT garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” dhe mbështetjen e studentëve.*
- *KPT zhvillon aktivitetin si institucion privat i arsimit profesional të lartë dhe çdo vit harton një raport financiar, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*
- *Institucioni ka kryer auditimin periodik çdo vit nga palë të treta, duke vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij, si edhe raporton çdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

CEVY shka


S

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> | <p>KPT, DEMSA kanë hartuar kuadrin ligjor si Rregullore, Udhëzime, procedura, të cilat zbatohen në të gjithë rrugëtimin e një studenti: informimin, pranimin, përparimin, transferimin/njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjeshme, vlerësimin e dijeve/ankimimin dhe në fund diplomimin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e institucionit. KPT kujdeset edhe për studentët pas diplomimit. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e KPT zhvillohet në përputhje me rregulloret, udhëzimet.</p> <p>I gjithë informacioni i nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, i transmetohet studentëve në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informacione në format elektronik, ku burimi kryesor mbetet faqja website e KPT, platformat e menaxhimit mësimor (sistemi Classter) dhe komunikimi me email; - Takime të drejtpërdrejta të studentëve, apo klasës; - Me guida, manuale, rregullore të cilat i vihen në dispozicion studentëve; informacione të shpallura si orari, njoftime etj. <p>Ref: Evidenca 3 Statuti i KPT Ref: Evidenca 4 Rregullorja e KPT Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit TAK Ref: Evidenca 5.1 Rregullore e praktikës profesionale Ref: Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit TAK Ref: Evidenca 13.1 Rregullore e NjSCB Ref: Evidenca 32 Rregullore e sekretarisë mësimore http://kolegjiprofesional.edu.al/</p> <p>Ref: Evidenca 24.1 TURET.pdf Ref: Evidenca 24.2 OPEN DAYS NE KPT.pdf Ref: Evidenca 24.3 Screen Shot e Tur 360 grade.pdf Ref: E 24.4 Panairret work & Study Panairi House of Europe.pdf</p> |
| <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të</p> | <p>Politikat dhe procedurat në hyrje në KPT, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë, sepse</p> |



| | |
|--|--|
| <p>gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>bëhen <i>nëpërmjet</i> Maturës shtetërore dhe U-Albania që është ngritur mbi politikën <u>meritë-preferencë</u> të kandidatëve për studentë. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, të ndjekura nga KPT, janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ato kanë garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë duke përfshirë dhe studentët e programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”. KPT si Kolegj profesional ofron vetëm programe profesionale, dhe sipas ligjit nuk ka kusht të notës mesatare për kandidatët.</p> <p>Ref: Evidenca 3 Statuti i KPT Ref: Evidenca 4 Rregullorja e KPT Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit TAK</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p> | <p>Sipas RVB e DVV, kriteret e pranimit të studentëve për çdo program studimi për Kolegjin Profesional të Tiranës, për çdo vit akademik përcaktohen me Vendim Senati Akademik.</p> <p>Sipas akteve ligjore në fuqi, KPT ka detyrimin e dorëzimit të kriterëve të pranimit të studentëve dhe të kuotave përkatëse çdo vit akademik pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, për çdo program në përputhje me kapacitetet që disponon institucioni dhe që i nënshtrohen verifikimit nga kjo ministri. Pas miratimit këto vendosen në portalin U-Albania.</p> <p>GVJ konstaton se KPT përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit që ofron, nëpërmjet shpalljeve në ambientet e tij dhe të publikimit në faqen e internetit të KPT, si edhe informimit nëpërmjet website, rrjeteve sociale, etj. Informimi dhe ndërgjegjësimi për t’u regjistruar në Kolegjin Profesional të Tiranës realizohet në përputhje me “Politikën e procedurat e Komunikimit në KPT” nëpërmjet këtyre formave: takimeve informuese me nxënësit e shkollave të mesme, shpërndarje e fletëpalosjeve, postera, broshura, etj, dalje publike të përfaqësuesve të KPT në media dhe /ose në panairë e evente të ndryshme, etj.</p> <p>https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/ Ref: Evidenca 23 Vendimet SA Ref: Evidenca 24 POLITIKAT E KOMUNIKIMIT.pdf</p> |
| <p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit</p> | <p>GVJ konstaton se në të gjitha strategjitë, rregulloret ku përfshihen kriteret/procedurat e pranimit, përparimit përgjatë kursit të studimit, transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, janë shkruar në gjuhë të kuptueshme për studentin dhe janë të publikuara në</p> |

CEVY shles



| | |
|---|--|
| <p>janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> | <p>faqen elektronike të KPT. Ato janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga kandidatët për studentë dhe për publikun e gjerë. Faqja zyrtare përmban informacion të detajuar në lidhje me: strukturën dhe organizimin e KPT, programet mësimore, personelin, shërbimet, oferta akademike, pranimet dhe kriteret e pranimit, syllabuset për lëndë, aktet rregullatore të Institucionit, Statutin, mundësi aplikimi për punë dhe kontakte, informacione të cilat përditësohen me kujdes në përputhje me Politikën e Manaxhimit të faqes së Internetit. Në fillim të çdo viti akademik KPT dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar. Procedura e pranimit bëhet sipas udhëzimit të MAS. Transferimi i studimeve, njohja dhe njehsimi i diplomave është përcaktuar qartë në Statutin e KPT dhe në rregulloren e programit të studimit TAK.</p> <p>http://kolegji profesional.edu.al/ Ref: Evidenca 24.1 TURET.pdf Ref: Evidenca 24.2 OPEN DAYS NE KPT.pdf Ref: Evidenca 24.3 Screen Shot e Tur 360 grade.pdf Ref: E 24.4 Panairt Eëork & Study Panairi House of Europe.pdf Ref: Evidenca 3 Statuti i KPT Ref: Evidenca 4 Rregullorja e KPT</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> | <p>Sipas RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se: KPT ka objektiv të ndihmojë zhvillimin ekonomik dhe social në nivel kombëtar dhe rajonal, për këtë synon që të ofrojë shërbimet e tij në formë cilësore dhe efikase, duke e vënë theksin tek e drejta për arsim si një e drejtë kushtetuese dhe duke i kushtuar rëndësi përgjegjësisë sociale.</p> <p>KPT ka miratuar Rregulloren për studentët me aftësi ndryshe dhe ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për këtë. GVJ konstaton se KPT ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për këtë kategori studentësh përse i përket zhvillimit të procesit akademik dhe nevojave personale si dhe ka në planet e tij përmirësimin e vazhdueshëm të këtij shërbimi. Në lidhje me personat me aftësi ndryshe, KPT ka marrë masa që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për studentët me aftësi ndryshe, hyrja në KPT është në nivelin zero, çka e bën lehtësisht të aksesueshme; është parashikuar që mësimi të zhvillohet në mjedise të aksesueshme për ta dhe janë ndërtuar tualete të posaçme; • Për studentët e pakicave rome dhe ballkano-egjiptiane, KPT në vijimësi ka bërë parashikime në kuota, por nuk ka pasur raste të tilla. <p>Ref: Evidence 3 – Statuti, neni 6 (2) (b)</p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në</p> | <p>GVJ evidenton se një nga prioritetet e Kolegjit Profesional të</p> |




nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

Tiranës është të vlerësojë punën dhe meritat e çdo studenti dhe në të njëjtën kohë ta motivojmë atë. KPT ofron bursa në varësi të mesatares së notave në maturën shtetërore dhe/ose në vitet e studimit në KPT. Gjithashtu KPT ndan informacione të ndryshme në lidhje me mundësitë për bursa apo financime për studentët (si psh Bootcamp i sipërmarrjes, Connect IT projekt i GIZ dhe Bashkimit European etj).

Ref: Evidenca 39 Connect IT

Konkluzione

- *GVJ vlerëson se KPT ka hartuar, ndjek dhe zbaton politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studentëve, që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”.*
- *GVJ vlerëson si shumë të dobishme “Politikën e procedurat e Komunikimit në KPT”, që sjell informimin e të interesuarve dhe transparencë.*
- *KPT si institucion privat i arsimit të lartë profesional i nënshtrohet të gjithë kornizës ligjore në fuqi në lidhje me pranimet për studentët me aftësi të veçanta ose për disa kategori të veçanta.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | |

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | <p>Nga informacioni në RVB, DVV dhe nga takimet me studentë, GVJ konstaton se studentët, janë njohur dhe të qartë, lidhur me kriteret në përparimin akademik, kalimin nga një vit në tjetrin dhe kriteret për kalimin në çdo lëndë.</p> <p>Pranë KPT funksionon Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit, e cila në kuadër të politikave të pranimit jep informacion për KPT dhe programet e studimit që ofron si dhe orienton të interesuarit te zyrat përkatëse, Sekretaria Mësimore Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, dhe koordinatorët, të cilët luajnë një rol thelbësor në informimin dhe koordinimin e punës me studentët dhe stafin akademik.</p> <p>Në faqen e internetit publikohet dhe përditësohet informacion i plotë, i saktë dhe i detajuar në lidhje me portofolin dhe ofertën</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>akademike të KPT.</p> <p><i>GVJ konstatoi mospërputhje në kriteret për pjesëmarrjen në mësim (Rregulloren e KPT (neni 42) përkundrejt rregullores së Programit të studimit dhe syllabuseve). Kjo pasaktësi duhet adresuar sepse krijon paqartësi tek studentët.</i></p> <p>https://kolegjiprofesional.edu.al/programet-e-studimit-ne-kpt/</p> <p>Ref: Evidence 37/2 - Politika e Manaxhimit të faqes së Internetit Ref: Evidenca 3 – Statuti, neni 15, pika (4) Ref: Evidenca 24 – Politika e Komunikimit; Ref: Evidenca 24.1 TURET.pdf Ref: Evidenca 24.2 OPEN DAYS NE KPT.pdf Ref: Evidenca 24.3 Screen Shot e Tur 360 grade.pdf Ref: E 24.4 Panairt Work & Study Panairi House of Europe.pdf</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesëshme.</p> | <p>Në rregulloret e KPT dhe të programit të studimit ka edhe kritere/procedura për njohjen e kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesëshme. Për studentët që rregjistrohen si program i dytë ose transferohen në programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, komisioni ad-hoc bën njohjen e krediteve të fituara dhe ekuivalentimin e lëndëve.</p> <p>Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit TAK</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se në Rregulloren e KPT, Rregulloren e programit të studimit si dhe në syllabus-in e çdo lëndë, të cilat vihen në dispozicion të studentëve, përcaktohen kriteret dhe procedurat e vlerësimit të njohurive. Këtu përfshihen procedurat që duhen ndjekur, rregullat e hartimit të tezave, monitorimi dhe sekretimi i provimeve, e drejta e studentit për të hyrë në provim ose jo, vlerësimi i studentëve. Vlerësimi, i shprehur në notë dhe germë në rregulloret ka të përcaktuar qartë mënyrën, modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijes dhe veçanërisht të provimeve e riprovimeve që stafi akademik dhe studentët duhet të ndjekin.</p> <p>Ref: Evidenca 4 Rregullorja e KPT, Kreu V Ref: Evidenca 5 Rregullorja e programit TAK Ref: Evidenca 5.5 Syllabuset TAK</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se KPT/DEMSA ndjekin një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit. Në rregullore janë parashikuar kriteret dhe procedurat e diplomimit. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome ose dhënies së një Provimi të Përgjithshëm Përfundimtar, sipas vendimit të Rektorit për çdo vit akademik. Studentët vihen në dijeni për procedurat e lidhura me provimet dhe diplomimet nëpërmjet</p> |

CEY shka



| | |
|---|---|
| | <p>tutoriatit, komunikimeve para provimeve me anë të postës elektronike emaileve, sekretarisë akademike, titullarit të lëndës dhe publikimit në ambientet e KPT.</p> <p>Ref: Evidenca 4 Rregullorja e KPT, Neni 56 Mbrojtja e diplomës</p> |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p> | <p>GVJ konstaton se bazuar në parashikimet e Statutit, Rregullores KPT, detyrat funksionale dhe Politika e Komunikimit, Zyra e BNJ dhe Kontratave si dhe Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit dhe Sekretaria Mësimore, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në procesin e informimit dhe pranimit të studentëve të rinj. KPT shpërndan broshura dhe fletëpalosje informuese të cilat pajisen dhe QR Code, i cili duke u skanuar të drejton në faqet zyrtare të KPT, ku informacioni përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Për studentët e rinj, KPT organizon çdo vit, Javën e Orientimit të Studentëve, si dhe i vë në dispozicion studentit, Manualin e Studentit, një përmbledhje me informacion thelbësor për jetën e studentit në KPT. Në vijim studentët marrin informacion për përdorimin e platformave, llogarive, etj, në KPT nëpërmjet komunikimeve me zyrën IT dhe materialeve të përgatitura përkatësisht (manuale, video tutoriale, etj), materiale të përgatitura nga sekretaria në lidhje me çështje të ndryshme (kalendari akademik, orar mësimor, seanca sqaruese, konsulta, etj), etj.</p> <p>Ref: Evidenca 30 Java e Orientimit Ref: Evidenca 27 Manuali i Studentit Ref: E 25 Mësimi Online - ZYRA IT video tutorial / manual Ref: Evidenca 41 Emaillet njoftuese nga koordinatorët Ref: Evidenca 41/1 Kalendari akademik</p> |
| <p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>GVJ vlerëson se KPT vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimeve, syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program. GVJ konstatoi mospërputhje në kriteret për pjesëmarrjen në mësim (Rregulloren e KPT (neni 42) përkundrejt rregullores së Programit të studimit dhe syllabuseve). Kjo pasaktësi duhet adresuar sepse krijon paqartësi tek studentët.</i> • <i>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, KPT publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</i> • <i>Faqja zyrtare ueb është burim i rëndësishëm informacioni të nevojshëm në lidhje me programin mësimor. Institucioni informon studentët dhe publikun edhe përmes broshurave, fletëpalosjeve dhe fushatave të informimit.</i> • <i>Informim tek studentët jep edhe Sekretaria Mësimore, në drejtim të rregullave për</i> | |

frekuentimin, kalimin në vitet pasardhëse, etj

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | <p>Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se ato informohen në fillim të vitit për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”. Informacioni në lidhje me programin e studimit, stafin akademik që e mbështet, detyrimet e të dy palëve, etj është detyrë e Koordinatorës së DEMSA, pedagogëve të çdo lënde, Zyrës së BNJ dhe Kontratave, Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit si edhe sekretarisë mësimore.</p> <p>Ref: Evidence 37/1 Politika e Manaxhimit të faqes së Internetit) Ref: Evidence 37/2 screenshot i faqes së internetit KPT Ref: Evidence 27 MANUALI I STUDENTIT.pdf</p> |
| Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/ modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | <p>Studenti njihet me informacionin kryesor në lidhje me jetën e tij studentore nëpërmjet “Manualit të Studentit” dhe “Sistemit Classter”. Informacioni mundësohet edhe përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë nëpërmjet faqes online të KPT https://kolegjiprofesional.edu.al/programet-e-studimit-ne-kpt/</p> <p>Për çdo lëndë, studentit i vihen në dispozicion Syllabus i Lëndës, si dhe organizohen Tutoriatet.</p> <p>Ref: Evidenca 27 Manuali i Studentit Ref: Evidenca 28/1 Sistemi i Institucionit/Classter Ref: Evidenca 5.5 Syllabus (shembull) Ref: Evidenca 17 Tutoriatet këshillim akademik</p> |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | <p>GVJ nëpërmjet DVV dhe takimeve konstaton se: KPT nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit, për ata që janë të punësuar dhe për të ofruar mundësi punësimi, këshillim karriere për ata që nuk janë punësuar ende si dhe për t’i asistuar në hyrjen dhe</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>përshtatjen me tregun e punës. Njoftimet për punësim publikohen vazhdimisht në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • faqen e internetit të KPT, https://kolegjiprofesional.edu.al/mundesite-e-punesi-mit-dhe-intership/ • rrjetet sociale, ose/dhe iu dërgohen studentëve me anë të postës elektronike; • ekranin e madh në hollin e katit të parë të KPT. <p>Sipas RVB, evidentojmë se KPT organizon takime të hapura me biznese, industri e organizata në grupe dhe individuale të cilët promovojnë mundësitë e karrierës pranë tyre për studentët e KPT, jo vetëm në vend dhe jashtë, dhe zhvillimet e fundit në vend (si në Gjermani, etj, si ReMany, Ujësjellës Kanalizime Tirana, etj).</p> <p>Gjithashtu për të përgatitur edhe më mirë studentët për tregun e punës dhe atë të huaj, KPT organizon trajnime me palë të treta (si Bashkia Tiranë, Zyra e Këshillimit të Karrierës, etj), në lidhje me dosjen e karrierës, si përgatitjen e CV, letrës së motivimit etj.</p> <p>Një rol të rëndësishëm luajnë dhe mobilitetet pranë kompanive të huaja në vende të ndryshme të BE-së falë projekteve ndërkombëtare ku KPT është pjesë (si praktika 1 dhe 3 mujore në Budapest, Hungari, Greqi, Poloni).</p> <p>Një mundësi punësimi është praktika profesionale pranë bizneseve, që ofrojnë punësime pas mbarimit të saj.</p> <p>Ref: Evidenca 12 Sondazhi Alumni Ref: Evidenca 44 Thirrje / Njoftime Punësimi Ref: Evidenca 31 Takime me biznese Ref: Evidenca 21 Trajnime Student Ref: Evidenca 38 Praktika Connected through Mobility Ref: Evidenca 18.1 Panairi i punës ne KPT.pdf Ref: Evidenca 24.4 Panairt Eork and Study Panairi House of Europe.pdf</p> |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>GVJ konstaton se institucioni i jep studentëve informacion të gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën e logjistikën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stafit akademik që këshillon/informon çdo student të interesuar për programet e studimit; • Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit që e ka detyrë parësore ofrimin e shërbimit për studentët; • Rregullores KPT/Rregullores së programit të studimit (neni |




| | |
|---|---|
| | <p>12);</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontratës dy palëshe që nënshkruhet midis KPT dhe çdo studenti, në momentin e regjistrimit; • Javës së Orientimit, që organizohet në fillim të çdo viti akademik. <p>Koordinatorja e departamentit mban kontakte të rregullta, njoftime elektronike dhe me telefon me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit, për azhurnimin e tyre mbi infrastrukturën, aktivitete të ndryshme, informacione që lidhen me oraret etj. Çdo ndryshim në orar u njoftohet studentëve përmes koordinatorëve të departamenteve dhe shpallet në këndin e njoftimeve.</p> <p>Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor dërgohet përmes postës elektronike dhe sistemit Classter /Teams.</p> <p>Ref: Evidenca 4 Rregullorja KPT.pdf Ref: Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit TAK.pdf Ref: Evidenca 30 JAVA E ORIENTIMIT.pdf Ref: Model kontrate</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p> | <p>Nga DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve në KPT, krahas detyrave të tjera në bashkëpunim me departamentet, punon për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave mësimore, si dhe për të krijuar ura të forta lidhjeje dhe lehtësimin e integritimit në tregun e punës për studentët, si dhe për realizimin e këshillimit të duhur për karrierë. KPT bashkëpunon me emra të njohur të biznesit e industrisë, me institucione shtetërore dhe ente të pavarura, ku realizohet praktikë aftësuese në terren dhe ofrohen mundësi punësimi, të cilat ju bëhen me dije studentëve nëpërmjet komunikimeve me email, njoftimeve, etj. Edhe më lart është shkruar se në Dosje janë vendosur listat e bashkëpunimeve të KPT (124 institucione/ biznese/organizata) dhe për programin e studimit ku janë listuar 22 të tilla.</p> <p>Ref: Evidenca 33 Lista e Partnerëve Marrëveshjeve me subjektet pritëse – Marrëveshjet Ref: Evidenca 38 Praktika Connected through Mobility.pdf</p> |
| <p>Konkluzione</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>GVJ vlerëson se KPT ka vënë në dispozicion të studentëve struktura dhe mjete për informim, orientim dhe ndihmë, përkatësisht:</i> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit që e ka detyrë parësore ofrimin e shërbimit për studentët;</i> - <i>Stafin akademik që këshillon/informon çdo student të interesuar për programet e studimit;</i> | |




- Rregulloren KPT/Rregulloren e programit të studimit (neni 12);
- Kontratën dy palëshe që nënshkruhet midis KPT dhe çdo studenti, në momentin e regjistrimit;
- Javën e Orientimit, që organizohet në fillim të çdo viti akademik, etj.
- GVJ vlerëson se KPT ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.
- KPT informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizmit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen.


| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

| Kriteret | Vlerësimi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|--|--|------------------------|---|--------------------|------------------|--|-----------|----|---|----|--|-----------|----|---|----|--|-----------|----|---|----|---|--|--|--|-----------------|----------------|-------------------|-----------------------|-----------|-----|----|----|-----------|-----------|
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>GVJ evidenton se Kolegji disponon statistika të plota (regjistrimet, transferimet, çregjistrimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje, shkallën e punësimit) mbi ecurinë e studentëve. Programi i studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” është ofruar nga KPT për herë të parë në vitin 2015. Të dhëna për Studentët sipas viteve:</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Programi 2-vjeçar i studimeve Diplomë Profesionale në Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi</th> <th>Sipas viteve akademike</th> <th>Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)</th> <th>Të transferuar (b)</th> <th>Totali (a) + (b)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>2020-2021</td> <td>11</td> <td>1</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td></td> <td>2021-2022</td> <td>11</td> <td>1</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td></td> <td>2022-2023</td> <td>22</td> <td>-</td> <td>22</td> </tr> </tbody> </table> | Programi 2-vjeçar i studimeve Diplomë Profesionale në Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi | Sipas viteve akademike | Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a) | Të transferuar (b) | Totali (a) + (b) | | 2020-2021 | 11 | 1 | 12 | | 2021-2022 | 11 | 1 | 12 | | 2022-2023 | 22 | - | 22 | <p>Studentë të diplomuar sipas viteve:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Vitet akademike</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Studentë inaktivë</th> <th>Studentë të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017-2018</td> <td rowspan="4">140</td> <td rowspan="4">33</td> <td rowspan="4">74</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> </tr> </tbody> </table> | | | | Vitet akademike | Të regjistruar | Studentë inaktivë | Studentë të diplomuar | 2017-2018 | 140 | 33 | 74 | 2018-2019 | 2019-2020 |
| Programi 2-vjeçar i studimeve Diplomë Profesionale në Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi | Sipas viteve akademike | Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a) | Të transferuar (b) | Totali (a) + (b) | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 2020-2021 | 11 | 1 | 12 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 2021-2022 | 11 | 1 | 12 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 2022-2023 | 22 | - | 22 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Vitet akademike | Të regjistruar | Studentë inaktivë | Studentë të diplomuar | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2017-2018 | 140 | 33 | 74 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2018-2019 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2019-2020 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2020-2021 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | 2021-2022 | | | |
| | 2022-2023 | | | |
| | <p>Numrat e studentëve të regjistruar në këtë program studimi janë të vegjël dhe institucioni në vitin e fundit ka përmirësuar punën e tij në drejtim të thithjes së një numri më të madh studentësh krahasuar me dy vite më parë.</p> <p>Ref: Evidenca 6 Të dhënat e studentëve në vite.pdf Ref: Evidenca Tabela TA TAK.pdf</p> | | | |
| <p>Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> | <p>Në takime u theksua edhe roli i Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Kontratave që nëpërmjet Sistemit Classter mban rekorde të detajuara për studentët e regjistruar, studentët me bursë, të çregjistruarit dhe të pezulluarit me numrin përkatës të matrikullimit për çdo program studimi. Të dhënat statistikore nxirren nga dokumentet bazë: Regjistri themeltar, Regjistri i arritjeve akademike; Regjistri i diplomave.</p> <p>Ref: Evidenca 28/1 Sistemi i Institucionit/Classter Ref: Evidenca 45 Regjistri baze themeltar.pdf Ref: Evidenca 45.1 Regjistri i arritjeve akademike.pdf Ref: Evidenca 45.2 Regjistri i diplomave.pdf</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> | <p>Dokumentacioni ruhet në format fizik dhe elektronik sipas rregullave në fuqi. KPT realizon kontroll të vazhdueshëm dhe menaxhim nga të gjitha njësitë mësimore dhe administrative, në dokumentacione dhe evidencat përkatëse, që lidhen me procesin mësimor dhe veprimtarinë e studentëve. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Platforma Classer ndihmon në lidhje me vlerësimet e stafit akademik për çdo provim, detyrimet e studentëve, etj. Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht nga Rektori dhe strukturat drejtuese.</p> <p>Sipas kërkesave ligjore, institucioni ka të detyrueshme ruajtjen e të dhënave si në Regjistrin themeltar, Regjistrin e arritjeve (notave) dhe Regjistrin e Lëshimit të Diplomave në dy forma: hardcopy dhe në formë dixhitale. GVJ konstatoi se për këtë program studimi janë hedhur të dhënat në dy format.</p> <p>Ref: Evidenca 45 Regjistri bazë themeltar Ref: Evidenca 45.1 Regjistri i arritjeve akademike Ref: Evidenca 45.2 Regjistri i diplomave</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e</p> | <p>Departamenti i Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, si njësi bazë për programin e studimit TAK, në bashkëpunim me Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Sekretarinë Mësimore, vlerësojnë cilësinë në hyrje dhe në dalje</p> | | | |



| | |
|--|---|
| <p>cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>të studentëve për çdo program studimi. DEMSA çdo vit realizon Raportin vjetor, si pjesë e raportit vjetor të KPT.</p> <p>Feedback i vlerësimit të studentëve gjatë praktikës profesionale, mobilitetit në vendet e BE-së si dhe punësimi i studentëve janë tregues që mbahet parasysh në vlerësimin e cilësisë së studentëve. Kjo nga ana tjetër vlen dhe për rishikimin dhe vlerësimin periodik të kurrikulës.</p> <p>Ref: Evidenca 6.6 Raporti i cilësisë së studentëve Ref: Evidenca 5.2 Raporti i praktikave.pdf Ref: Evidenca 36 Raporti vjetor.pdf</p> |
|--|---|

Konkluzione

- *GVJ konstaton struktura të ngritura brenda institucionit në lidhje me menaxhimin e të dhënave të studentëve.*
- *GVJ vlerëson se KPT dhe DEMSA nëpërmjet këtyre strukturave mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht nga Rektori dhe strukturat drejtuese.*
- *KPT harton raporte analitike vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p> | <p>GVJ konstatoi se në Statutin e KPT (neni 46) KPT ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit dhe organigramës së saj. Dy strukturat më të larta ku përfshihen studentët janë Senati dhe NJBSC. Këshilli i studentëve është organizëm i pavarur i studentëve të KPT, i zgjedhur në mënyrë demokratike nga vetë studentët dhe përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e tyre. Këshilli i studentëve zgjidhet çdo 2 (dy) vjet nga votat e studentëve, një përfaqësues për çdo program studimi dhe vit studimi. Përbërja e Këshillit të Studentëve publikohet në faqen e internetit të KPT:</p> |

CEV shka

| | |
|---|---|
| | <p>https://kolegjiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/</p> <p>Ref: Evidenca 2 Statuti KPT, neni 46</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> | <p>KPT ka garantuar përfshirjen e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse, këshillat, etj. Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. GVJ konstaton se përfshirja e tyre është reale, si anëtarë në Senatin Akademik dhe në Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, etj.</p> <p>Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të KPT, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. Në KPT studentët bëjnë vlerësimin anonim të pedagogëve me të cilët kanë zhvilluar mësim.</p> <p>Ref: Evidenca 15 Formularet e vlerësimit Studente Ref: Evidenca 16 Fokus Grupe</p> |
| <p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p> | <p>Në përmirësimin e programit të studimit, DEMSA ka realizuar diskutime dhe ka kërkuar sugjerime për: ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit ka pësuar ndryshime e përmirësime në disa lëndë në kuadër të projektit ENGINE.</p> <p>KPT e vlerëson cilësinë e jetës studentore si një element të rëndësishëm të cilësisë së IAL. Për këtë arsye, KPT synon dhe investon të sigurojë një ambient sa më miqësor, të shëndetshëm dhe bashkëpunues me studentët. KPT ka përfshirë studentët në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programeve lëndore, duke reflektuar sugjerimet e tyre. Këto sugjerime merren në mbledhje të përbashkëta në departament, ose me pyetësorë, ose me grupe fokusimi.</p> <p>Ref: Evidence 15 Formularet e vlerësimit Studente, Ref: Evidencë 16 Fokus Grupe, Ref: Evidenca 17 Tutoriatet/ këshillim akademik; Ref: Evidence Mbledhje e Asamblesë së Personelit</p> |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe</p> | <p>GVJ evidenton se sipas rregullores së KPT, neni 49, studentëve</p> |

(Signature)

(Signature)

| | |
|---|---|
| <p>ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p> | <p>u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit.</p> <p>Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.</p> <p>Nga takimet me studentët, GVJ konstaton se, në rast se studenti ka ankesë për vlerësimin (kolokium, detyrë kursi/detyra praktike/ punë laborator, ushtrime, provim përfundimtar), në fillim e sqaron pedagogu i lëndës që e ka vlerësuar. Nëse ka përsëri paqartësi mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit me një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Rektori, kur pedagogu lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, ku bën pjesë dhe pedagogu i lëndës, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar.</p> <p>Ref: E 5 Rregullorja e Programit të Studimit, neni 8, pika 6 Ref: Evidenca 42 Formular kërkesë</p> |
|---|---|

Konkluzione

- *GVJ vlerëson se KPT me akte ligjore përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. GVJ konstaton se studentët janë anëtarë në NjBSC dhe në Senatin Akademik.*
- *Gjithashtu studentët përfshihen në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre. Kjo përfshirje realizohet me pyetësorët që realizohen çdo vit dhe për çdo lëndë, me fokus-grupet, etj.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X |

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve,</p> | <p>GVJ konstaton se në orientimin dhe këshillimin e studentëve është i ndarë në dy faza: për maturantët që duan të ndjekin</p> |

(Signature)

(Signature)

në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.

studimet pranë KPT dhe për studentët që tashmë janë regjistruar në KPT.

Procedurat/aktivitetet në funksion të pritjes, orientimit, këshillimit të studentëve janë:

- Java orientimit të studentëve;
- Faqja internetit/rrjetet sociale;
- Rekomandimet e alumnit, etj.

Strukturat në funksion të këshillimit të studentëve, menaxhimit të ankimeve dhe problematikave janë kryesisht:

- Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve, si për informimin për kolegjin; organizimin e jetës studentore, etj;
- Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave;
- Koordinatorët mësimorë;
- Struktura dhe anëtarë të stafit (në varësi nga natyra e çështjes).

Këto njësi/struktura kanë procedurë gjithëvjetore në shërbim të studentëve dhe rregullore të funksionimit të tyre. Në vijim studentët marrin informacion për përdorimin e platformave, llogarive, etj në KPT nëpërmjet komunikimeve me zyrën IT dhe materialeve të përgatitura nga sekretaria.

Ref: Evidenca 4 Rregullorja KPT.pdf

Ref: Evidenca 5 Rregullorja e Programit të Studimit TAK.pdf.

Ref: Evidenca 46 Broshura KPT.pdf

Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.

Studenti njihet me informacionin kryesor në lidhje me jetën e tij studentore nëpërmjet “Manualit të Studentit” dhe “Sistemit Classter”.

Sipas RVB e takimeve në institucion, GVJ konstaton se KPT ofron Tutoriatin gjatë gjithë vitit akademik, sipas semestrave dhe orareve të përshtatshme për pedagogët dhe studentët, si dhe përmes internetit. KPT iu ofron studentëve edhe seanca konsultuese për çdo lëndë para provimit përfundimtar nga pedagogu i lëndës. Brenda javës nga momenti i daljes së rezultateve të provimit për çdo provim caktohet një orar për seancë sqaruese. Për studentët që hasin vështirësi, KPT ofron orë/seanca shtesë sipas kërkesës së studentëve ose kur KPT e gjykon të arsyeshme.

Nëpërmjet sistemit të menaxhimit Classter pedagogu ju mundëson studentëve materiale si literaturën, syllabuse, ushtrime, etj, i cili është i integruar Office365 për të lehtësuar aksesimin e të dhënave. Portali i Studentit Classter ofron akses në: orarin mësimor për çdo semestër; programet e lëndëve; pikët

| | |
|---|--|
| | <p>për çdo lëndë, me gjithë komponentët e vlerësimit; njoftime të ndryshme në lidhje me aktivitetet që zhvillohen.</p> <p>Ref: Evidence 17/1 Rregullorja Tutoriati; Evidence 41 Emaillet njoftuese nga koordinatoret Evidence 42 Formular kërkesë Evidence 3 – Statuti Evidence 4 – Rregullorja KPT https://kolegji-profesional.edu.al/keshillimi-akademik-tutoriati/</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> | <p>Nga organigrama dhe nga RVB kontatojme se strukturat që kanë këtë detyrë janë: Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve dhe Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave.</p> <p>Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve organizon, menaxhon dhe drejton këshillimin e studentëve në lidhje me procesin akademik dhe çështje të tjera të lidhura me to, si dhe bashkëpunon ngushtë me departamentet për organizimin dhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Kjo lidh dhe lehtëson integrimin e studentëve në tregun e punës dhe i shërben realizimit të këshillimit për karrierë.</p> <p>Në sistemin e informimit ndihmon edhe koordinatori i programit të studimit, i cili jep ndihmesë lidhur me ndjekjen e ecures së studentëve në institucion si dhe për të parë e trajtuar problematikat që ata kanë. Gjithashtu për të përgatitur edhe më mirë studentët për tregun e punës dhe atë të huaj, KPT organizon panairë pune, trajnime me palë të treta (si Bashkia Tiranë, Zyra e Këshillimit të Karrierës etj). Një rol të rëndësishëm luajnë dhe mobilitetet pranë kompanive të huaja në vende të ndryshme të BE-së falë projekteve ndërkombëtare ku KPT është pjesë, si praktika 1-3 mujore në Hungari, Poloni, Greqi etj. Për këtë program studimi ka 2 mobilitete për studentë dhe disa të tilla për pedagogët e DEMSA. Siç është theksuar edhe më lart pjesë e punës informuese janë edhe tutorët, faqja e internetit, etj. KPT ka organizuar disa takime të hapura me biznesin, industrinë dhe organizata etj, të cilët promovojnë mundësitë e punësimit të studentëve të KPT, dhe zhvillimet e fundit në vend, si takimet me ReMany, me Ujësjellës Kanalizime Tirana, me Dhomën e Tregtisë në Austri, me Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve Kosovë, etj.</p> <p>Ref: Evidence 18.1 Panairi i Punës Ref: Evidence 21 Trajnime student Ref: https://kolegji-profesional.edu.al/keshillimi-akademik-</p> |

CEly shles



| | |
|---|---|
| | <u>tutoriati /</u> CTM Greece, contracts E.N.pdf CTM Greece, selection process.pdf CTM POLAND certificates (L.S).pdf CTM Poland selection process.pdf |
| Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse | KPT nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, mban kontakte me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit. Zyra mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit, për ata që janë të punësuar dhe për të ofruar mundësi punësimi dhe këshillim karriere për ata që nuk janë punësuar ende. Kjo Zyre mban një database me të dhënat e çdo studenti të diplomuar, mban statistikën përkatëse; përpunon statistikën dhe gjeneron raporte në lidhje me to të cilat i vë në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Ref: Evidenca 12 Sondazhi Alumni Ref: Evidenca 12.2 Punësimi i Studentëve Ref: Evidence 18/1 Panairi i Punës |

Konkluzione

- *GVJ vlerëson se KPT ka procedura e njësi të posaçme (Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve; Sekretaria mësimore; Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave) për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave. Këto njësi e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.*
- *Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve i ndjek studentët pas diplomimit, mban të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve të programit të studimit, dhe informon organet e autoritetet drejtuese/ose politikëbërëse.*
- *Në programin e studimit TAK 2 (dy) studentë kanë kryer mobilitete në Greqi/Poloni, ndërsa pedagogët në disa vënde të BE.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|--|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Edy shka

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”

a. Pika të forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit me karakter profesional “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, është ndër programet e para të hapura në këtë disiplinë në IAL-të private në Shqipëri. Ai ka kontribuar në kualifikimin e profesionistëve dhe ekspertëve të parë të fushës në arsimin e lartë dy vjeçar. Programi i studimit TAK dhe kurrikula e tij, është tërësisht e orientuar dhe në përputhje me tregun e punës e kërkesat e tij;
2. Në programin e studimit “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” dallohet si mjaft pozitive që rreth 30% e programit i dedikohet aftësisht në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit që sjell shkallë të lartë të punësimit të studentëve. KPT kontribuon në gjetjen e mundësive të punësimit, nëpërmjet panairove të punës, punësimit gjatë praktikës profesionale dhe kontakteve direkte me biznesin;
3. KPT/DEMSEA bashkëpunon me biznesin dhe dhomat e tregtisë, që ofrojnë praktika profesionale dhe vizitat në terren, si pjesë e rëndësishme e programit të studimit. Bizneset me të cilat janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi janë punëdhënës të potencialë të studentëve që gjatë praktikës profesionale. Ato në shumë raste kanë rol këshillues në përmirësimin e programit të studimit dhe kurrikulës. Kjo lidhje mbështetet nga Zyra USIA apo Go+Learn që ndihmojnë në forcimin e marrëdhënieve me biznesin;
4. Infrastruktura dhe ambientet mësimore në funksion të programit të studimit janë të përshtatshme, me pajisjet e duhura. Laboratorët kanë teknologji dhe pajisje moderne profesionale, të cilat mundësojnë zbatimin në praktikë të dijeve teorike. Infrastruktura pasurohet edhe nga projektet ndërkombëtare ku KPT është partner;
5. KPT ka punuar për ndërkombëtarizimin e bashkëpunimeve dhe programit të studimit duke qenë partner në projekte si Erasmus + CBHE, Moduli Jean Monnet dhe projekte pilot të mobilitetit në arsimin profesional të mbështetur nga BE. Kjo ka mundësuar: a) trajnime të stafit për metoda inovative të mësimdhënies, b) rritje kapacitësh për stafin akademik dhe administrativ; c) internship për studentët pranë kompanive europiane. Aktualisht janë zhvilluar praktikat për grupin e parë të studentëve në afat 1-3 mujor, pranë kompanive në Poloni, Greqi, etj;
6. Personeli akademik është i kualifikuar, me karrierë akademike dhe profesionale. KPT dhe Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave synojnë që ai të jetë një kombinim i brezave dhe përvojave;
7. Veprimtaria akademike dhe administrative kontrollon nga rregullore/urdhëra/akte rregullatore, që janë publike dhe transparente. KPT, DEMSEA dhe zyrat përgjegjëse synojnë të plotësojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për funksionimin e tij në përputhje të kërkesave të Ligjit nr. ligjin 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSh” i ndryshuar dhe akteve nënligjore;

b. Pika të dobta:



2. Nga shqyrtimi i gjithë dokumentave kurrikulare rezultuan disa pasaktësi/lapsuse të cilat Institucioni i korigjoi menjëherë;
3. Në kriteret e pranimit të studentëve nuk është vënë kriter hyrës njohja e gjuhës shqipe, për studentët e huaj, që duan të studjojnë në KPT; (*Standardi II.3, Kriteri 3*)
4. Pavarësisht harmonizimit të brezave të stafit akademik, institucioni vetë deklaroi se ka vështirësi në gjetjen e stafit zëvendësues në vijimësi; (*RVB-pika të dobta*)


Rekomandime

1. GVJ sugjeron hartimin e raporteve periodike të përfitimeve për të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara, në funksion të ecurisë së programit të studimit TAK dhe përfitimit të studentëve;
2. GVJ rekomandon rishikimin e gjithë dokumentave kurrikulare për të rregulluar pasaktësitë/lapsuset në elementë të Planit mësimor, syllabuset, Rregulloret, etj;
3. GVJ rekomandon përmirësimin e ngarkesës për dy-tre anëtarë të stafit akademik që aktualisht mbulojnë 5-7 lëndë. GVJ rekomandon që KPT të punojë në drejtim të angazhimit të stafit të ri akademik, duke synuar zëvendësimin harmonik dhe me të njejtën cilësi të stafit aktual që e ka ngritur këtë program studimi në nivelin e sotëm;
4. GVJ rekomandon që në kriteret hyrëse të vihet si kriter specifik mbrojtja/njohja e gjuhës shqipe nga kandidatët e huaj për studentë, që kanë diplomë të maturës nga jashtë Shqipërisë;

Evaluation's conclusions for the professional study program "Professional diploma in "Airing and Conditioning Technology"

a. Strengths and affirmations:

1. The professional study program in "Air Conditioning Technology" (ACT) is among the first programs opened in this discipline in private HEI in Albania. He has contributed to the qualification of the first professionals and experts in the field in the two-year higher education. The ACT study program and its curriculum is completely oriented and in accordance with the labor market and its requirements;
2. In the "Air Conditioning Technology" study program, it stands out as quite positive that about 30% of the program is dedicated to training in practice/concrete work in the profession. The theory-practice ratio is in line with the profile of the study program that brings a high degree of student employment. Professional College of Tirana (PCT) contributes to finding employment opportunities through job fairs, employment during professional practice and direct contacts with business;
3. PCT/ Department of Electro-Mechanics and Applied Systems (DEMAS) collaborates with business and chambers of commerce, offering professional internships and field visits as an important part of the study program. The businesses with which cooperation agreements have been signed are the potential employers of the students during the professional practice. In many cases, they have an advisory role in improving the study program and curriculum. This link is supported by the USIA Office or Go+Learn that help strengthen business relationships;



3. PCT/ Department of Electro-Mechanics and Applied Systems (DEMAS) collaborates with business and chambers of commerce, offering professional internships and field visits as an important part of the study program. The businesses with which cooperation agreements have been signed are the potential employers of the students during the professional practice. In many cases, they have an advisory role in improving the study program and curriculum. This link is supported by the USIA Office or Go+Learn that help strengthen business relationships;
4. The infrastructure and teaching facilities in function of the study program are adequate, with the appropriate equipment. The laboratories have modern professional technology and equipment, which enable the practical application of theoretical knowledge. The infrastructure is also enriched by international projects where PCT is a partner;
5. PCT has worked for the internationalization of collaborations and the study program by being a partner in projects such as Erasmus + CBHE, the Jean Monnet Module and pilot projects of mobility in professional education supported by the EU. This has enabled: a) staff training for innovative teaching methods, b) capacity building for academic and administrative staff; c) internship for students at European companies. Currently, internships have been developed for the first group of students for a period of 1-3 months, near companies in Poland, Greece, etc;
6. The academic staff is qualified, with an academic and professional career. The PCT and the Office of Human Resources and Contracts aim for it to be a combination of generations and experiences;
7. Academic and administrative activity is controlled by regulations/orders/regulatory acts, which are public and transparent. PCT, DEMAS and the responsible offices intend to complete all the necessary documentation for its operation in accordance with the requirements of Law no. Law 80/2015 "On Higher Education and Scientific Research in HEI" as amended and by-laws;

b. Weaknesses:

1. External Evaluation Group (EEG) finds that PCT/DEMAS have not drawn up the periodical reports of benefits, for all cooperation agreements signed, in function of the progress of the ACT study program and the benefit of students; (*Standard I.2, Criterion 4*)
2. From the review of all curriculum documents, some inaccuracies/slips were found which the Institution corrected immediately;
3. In the admission criteria for students, knowledge of the Albanian language is not an entry criterion for foreign students who want to study at PCT; (*Standard II.3, Criterion 3*)
4. Despite the harmonization of generations of academic staff, the institution itself declares that it has difficulties in finding replacement academic staff in the future; (*SER-weak points*)





Recommendation

1. EEG suggests drawing up periodical benefit reports for all cooperation agreements signed, in function of the progress of the "ACT" study program and student benefit;
2. EEG recommends reviewing all curriculum documents to correct inaccuracies/slips in elements of the curriculum, syllabuses, Regulations, etc;
3. EEG recommends improving the workload for two-three academic staff members who currently cover 5-7 subjects. Also, recommends that the PCT work towards the engagement of new academic staff, aiming at the harmonious replacement and with the same quality of the current staff, that has raised this study program to today's level;
4. EEG recommends that in the entrance criteria, the defense/knowledge of the Albanian language by foreign candidates for students, who have a high school Diploma from outside Albania, should be set as a specific criterion;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit të studimit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |

ce Vyshteg

[Signature]